

BIARN

BALKAN
INVESTIGATIVE
REPORTING
NETWORK

KOSOVO



Sfidat e mekanizmave të parandalimit të terrorizmit në Kosovë



Tabela e përmbajtjes

I. Përmbledhje ekzekutive/Gjetjet kryesore	7
II. Hyrje	11
III. Metodologjia	13
Gjetjet kryesore: Analiza e progresit në nivelin e prodhimit	15
Tema - Lista e grupeve të popullsisë të synuara për radikalizëm dhe të ndjeshme ndaj faktorëve nxitës dhe tërheqës ndaj radikalizimit	19
Tema - Hartimi dhe shpërndarja e një udhëzuesi për institucionet për identifikimin e faktorëve të rrezikut të hershëm të radikalizimit	22
Tema - Policimi në komunitet shtrihet në lokalitete me njerëz të cenueshëm ndaj radikalizimit dhe zbatohet rregullisht	26
Tema - Themelimi dhe funksionalizimi i Këshillave të Sigurisë në Komunitete me njerëz të cenueshëm ndaj radikalizimit	29
Tema - Shkollat në lokalitete me njerëz të cenueshëm ndaj radikalizimit punësojnë psikologë dhe profesionistë të tjerë për t'u marrë me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit	32
Tema - Takimet në lagje/fshatra ndërmjet komuniteteve lokale dhe institucioneve të zbatimit të ligjit, për të ndërtuar besimin dhe partneritetin si mekanizma reagimi ndaj radikalizimit	38
Tema - Takime në lagje në lokalitete të cenueshme për të informuar publikun mbi rolin e familjes në identifikimin e ndryshimeve në sjelljen e familjes që mund të lidhen me radikalizimin	41
Tema - Krijimi i materialeve ndërgjegjësuese publike (fletëpalosje, fletushka, etj.) për identifikimin e ndryshimeve në sjellje të njerëzve që mund të lidhen me radikalizimin	43
Tema - Identifikimi dhe trajtimi i subjekteve në burgje të cenueshëm ndaj radikalizimit	46
V. Analiza e Impaktit	47
VI. Probleme ndërsektoriale	50
VII. Përfundime dhe rekomandime	53



Autorë: Labinot Leposhtica, Kreshnik Gashi

Metodologjia e kërkimit: Kreshnik Gashi

Hulumtues: Adelina Ahmeti, Shkodrane Dakaj, Laurant Berisha, Behar Mustafa, Egzon Dahsyla

Redaktorë: Albulena Sadiku, Përparim Isufi

Lektor: Përparim Isufi

Koordinatorë e Projektit: Iliria Kajdomqaj

Shkurtesat

Strategjia	Strategjia Shtetërore për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizmit 2023-2028
Plani i Veprimit	Plani i Veprimit 2023-2025
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
KKSB	Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkës
KLSP	Këshilli Lokal i Sigurisë Publike

I. Përmbledhje ekzekutive / Gjetjet kryesore

Strategjia Shtetërore për Parandalimin dhe Luftimin e terrorizmit në objektivat e saj strategjike e ka të prioritetuar parandalimin e terrorizmit. Si strategji e re ajo synon të krijojë qasje më të gjerë në trajtimin e terrorizmit duke zgjeruar fokusin edhe në ekstremizmin e djathtë.

Parandalimi i hershëm i faktorëve shtytës dhe nxitës të ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm është njëra nga objektivat e rëndësishme të fushës së parandalimit. Në këtë drejtim strategjia ka paraparë aktivitete konkrete të cilat do krijonin një ambient ku terrorizmi parandalohet në fazën e hershme.

Si fushë e re e përfshirë në strategjinë momentale, koncepti i parandalimit të hershëm është në fazën fillestare të zhvillimit. Një pjesë e institucioneve të thirrura për të zbatuar këto programe janë në fazën e ngritjes së kapaciteteve të brendshme ndërsa sfiduese mbetet gjithpërfshirja etnike e problematikës për shkak të mungesës së qasjes në shkollat dhe aktivitetet kulturore që zhvillohen nga komuniteti serb në Kosovë.

Të dhënat e grumbulluara nga BIRN identifikojnë probleme serioze në implementimin e këtyre aktiviteteve:



Institucionet e Kosovës nuk kanë ndërmarrë hapa konkretë në parandalimin e hershëm të të gjitha formave të terrorizmit

Gjatë viteve 2023-2026, Kosova ka vazhduar të përballet me terrorizmin. Brenda vendit ka pasur disa sulme terroriste të nxitura nga grupet e ekstremit të djathtë dhe nga grupet ekstremiste fetare islamike.

BIRN gjen se që nga miratimi i strategjisë e deri në hartimin e këtij raporti, institucionet e Kosovës kanë vazhduar t'i fokusojnë energjitë e tyre në fushat e luftimit dhe rehabilitimit ndërsa kanë shmangur obligimet për parandalimin e hershëm. Shumica e aktiviteteve të parapara në këtë fushë nuk janë realizuar apo janë në fazën përgatitore të nisjes për t'u realizuar. BIRN gjithashtu gjen se fokusimi i institucioneve në trajtimin e ekstremizmit fetar ka lënë boshllëqe të mëdha në ndërtimin e kapaciteteve për trajtimin e ekstremizmit të djathtë.



Institucionet qendrore e lokale kanë probleme serioze në kuptimin e mesazhit strategjik të strategjisë dhe hartimin e planeve individuale të implementimit

BIRN ka konstatuar se qeveria e Kosovës nuk e ka dorëzuar zyrtarisht dokumentin bazik dhe planin e veprimit të strategjisë te disa prej institucioneve të cilat janë të thirrura për ta implementuar strategjinë. Problemet serioze janë identifikuar në komuna ku nuk është dorëzuar strategjia dhe plani i veprimit.

BIRN gjen që në komunën e Mitrovicës ku është krijuar mekanizmi referues, grupi nuk e ka pranuar dokumentin strategjik ndërsa në një komunë tjetër - atë të Hanit të Elezit - strategjia është pranuar. Mungesa e dokumentit bazik ka krijuar probleme të tjera sistematike. Komunitat nuk kanë hartuar planet e veçanta të implementimit të strategjisë dhe nuk kanë caktuar personat përgjegjës për t'u marrë me aktivitetet konkrete në terren. Në nivelin qendror, strategjia është dërguar te ministritë e linjës përgjegjëse për implementimin e aktiviteteve.



Institucionet nuk kanë arritur që mbi bazën e studimeve të identifikojnë grupet e cenueshme dhe faktorët shtytës dhe nxitës të ekstremizmit

BIRN ka gjetur se një vit pas hyrjes në fuqi të strategjisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Arsimit, komunitat dhe aktorët tjerë nuk kanë kryer studime empirike që identifikojnë grupet e cenueshme të popullsisë ndaj radikalizmit dhe për faktorët nxitës e tërheqës. Realizimi i hulumtimeve ishte dizajnuar si baza e nisjes së aktiviteteve në terren dhe ky obligim ishte saktësuar edhe në planin e veprimit. Në mungesë të hulumtimeve, grupet e targetuara për aktivitete janë përcaktuar nga MPB në bazë të të dhënave mbi rastet, ndërsa komunitat kanë abstenuar pothuajse tërësisht nga ky aktivitet specifik.



Institucionet që realizojnë aktivitete në terren nuk kanë hartuar një listë gjithëpërfshirëse të subjekteve që janë cak i mundshëm për t'u radikalizuar dhe subjekteve që janë të ekspozuara ndaj faktorëve nxitës dhe tërheqës

BIRN ka gjetur se institucionet në nivelin qendror dhe në nivelin lokal nuk ka arritur të krijojnë një metodologji dhe mekanizëm i cili gjeneron një listë gjithëpërfshirëse në të cilën evidentohen subjektet e cenueshme për t'u radikalizuar. Të dhënat e BIRN tregojnë se komunitat në këtë drejtim janë në tërësi të varura ende nga niveli qendror. Në nivelin qendror, BIRN gjen se Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Arsimit grupet e cenueshme i grupojnë dhe identifikojnë në baza të dhënave të nxjerra nga rastet e deritanishme por nuk vërehet fokus në ekstremizmin e djathtë pasi të dhënat e përdorura janë kryesisht për ekstremizmin fetar.



Institucionet qendrore ende nuk kanë filluar punën në hartimin e një udhëzuesi për institucionet për qëllim të identifikimit të shenjave të hershme të radikalizmit

BIRN ka gjetur se Ministria e Punëve të Brendshme është në fazën fillestare të planifikimit të hartimit të një udhëzuesi për identifikim të shenjave të hershme të radikalizmit. Ministria e Arsimit ka një doracak të nxjerrë në vitin 2018 që përdoret ende për nevoja të mësimdhënësve teksa Instituti i Psikologjisë i Universitetit të Prishtinës ka realizuar një hulumtim "Nga Siria në Shtëpi" që trajton një fokus grup të caktuar - të rikthyerit nga Siria.

Niveli lokal, komunat, si adresë vazhdojnë ta kenë Policinë apo MPB-në, nuk kanë hulumtime specifike për territorin e tyre dhe në disa raste i referohen Strategjisë së kaluar dhe pothuajse kanë abstenuar nga roli i tyre në drejtim të identifikimit të shenjave të hershëm dhe kryesisht veprojnë post-festum.



Koncepti i policimit në komunitet nuk është zhvilluar mjaftueshëm për të përmbushur rolin në identifikim të hershëm

BIRN ka gjetur se në nivelin lokal nuk janë krijuar kapacitetet të plota që duke përdorur Konceptin e Policimit në Komunitet të synohet identifikimi dhe trajtimi i hershëm i terrorizmit. Nga 26 komuna që i janë përgjigjur BIRN, vetëm në 9 prej tyre evidentohet se ky koncept ka shtrirje dhe kuptim të drejtë. Më tej, edhe në komunat që ka shtrirje ky koncept nuk arrijnë të evidentojnë ndonjë rezultat specifik dhe paraqesin vështirësi edhe organizative dhe logjistike.



Këshillat e Sigurisë në Bashkësi nuk e kanë prioritet realizimin e aktiviteteve në kuadër të konceptit për parandalimit të hershëm

Të dhënat e BIRN evidentojnë se nga 26 komuna të vendit, vetëm në 10 prej tyre Këshillat Komunal të Sigurisë në komunitet janë funksionale. Nga të dhënat e siguruara del se 14 komuna nuk kanë qenë në gjendje që të ofrojnë përgjigje adekuate rreth funksionalitetit, rolit dhe ndikimit që kanë këto këshilla në parandalimin e radikalizmit dhe identifikimit të hershëm të tij. Të dhënat nga BIRN tregojnë që edhe përkundër shqetësimeve serioze në vend mbi ekstremizmin fetar dhe ekstremizmin e djathtë në nivel të këshillave kjo temë është injoruar. Në nivel vendi, nga 213 takime kjo është diskutuar vetëm në 7 takime.



Ministria e Arsimit ka progres të limituar në përmbushjen e objektivave dhe planit të veprimit

BIRN ka gjetur se Ministria e Arsimit ka rritur angazhimin e saj në drejtim të implementimit të aktiviteteve. Ministria ka njoftuar DKA-të për rolin e tyre në strategji ndërsa MASHTI ka caktuar një koordinator të brendshëm dhe ka ndërmarrë disa aktivitete në drejtim të implementimit të strategjisë. BIRN gjen se pjesa më e madhe e aktiviteteve janë zhvilluar në kuadër të programit R&R dhe nuk ndërlidhen me fazën e hershme të parandalimit. MASHTI është në fazën e hershme të ndërhyrjes me aktivitete me prindërit ndërsa aktivitetet direkte në terren me kampe, mendim kritik nuk janë realizuar edhe pse janë të parapara në planin e veprimit.



Komunat kanë bërë përpjekje për të shtuar numrin e profesionistëve, psikologëve, pedagogëve dhe trajnimin e tyre ndërsa evidentohen shumë mangësi sa i përket informimit të Këshillave të Prindërve dhe takimeve me ta

Tetë nga 26 komunat deklarojnë se kanë angazhuar psikologë e pedagogë gjatë periudhës që ka qenë objekt i raportit monitorues, teksa 9 prej 26 komunave deklarojnë se nuk kanë angazhuar psikologë ose nuk ka ofruar të dhëna që evidentojnë një gjë të tillë.

Në anën tjetër, 18 nga 26 komunat nuk e kanë informuar Këshillin e Prindërve sa i përket identifikimit të shenjave të hershme të radikalizmit si një nga obligimet që dalin prej strategjisë. Po ashtu, pjesa më e madhe e shkollave nuk kanë mbajtur takime informuese me Këshillin e Prindërve.

II. Hyrje

Kosova në mënyrë konstante është përballur me radikalizmin dhe terrorizmin ndërsa institucionet e vendit në një qasje multidisiplinare synojnë të identifikojnë shtytësit e radikalizmit të luftojnë terrorizmin dhe të rehabilitojnë dhe ri-integrojnë personat e përfshirë në aktivitete terroriste. Në nivelin kombëtar, aktivitetet në fushën e terrorizmit koordinohet nga një koordinator nacional i cili është person përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve në kuadër të strategjisë kundër terrorizëm. Ky dokument përfshin të gjitha institucionet vendore të cilat janë të thirrura për të realizuar aktivitete në implementimin e synimeve strategjike.

Strategjia Shtetërore për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizmit 2023-2028 është miratuar në qershor 2023 dhe është e bazuar në katër objektiva strategjike në të cilat hyjnë parandalimi, mbrojtja, ndjekja dhe reagimi.

Parandalimi është njëra nga shtyllat kryesore të strategjisë duke përfshirë të gjitha hapat që ndërmarrin institucionet për të adresuar shkaqet e radikalizimit dhe trajtimin e personave të përfshirë në veprime terroriste.

Si objektivi strategjik, parandalimi është i ndarë në disa aktivitete dhe ky raport monitorues është fokusuar në shtyllën e tretë të objektivit të Parandalimit e që konsiston në “Ndërhyrjen e hershme për të mbrojtur dhe mbështetur individët e cenueshëm nga radikalizmi”. Ky raport monitorues vlerëson masat e ndërhyrjes së hershme për të mbrojtur dhe mbështetur individët shumë të cenueshëm ndaj radikalizmit.

Qëllimi i raportit është mbledhja dhe prezantimi i të dhënave mbi implementimin e masave të planifikuara në Strategjinë Shtetërore për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizmit 2023-2028, specifikisht shtyllën e tretë të objektivit të Parandalimit që përfshinë ndërhyrjen e hershme për të mbrojtur dhe mbështetur individët e cenueshëm nga radikalizmi.

Në këtë drejtim, ky raport monitorues vlerëson përpjekjet si policimi në komunitet, iniciativat e shkollave dhe angazhimi i komunitetit për të parandaluar radikalizmin.

Identifikimi dhe ndërhyrja e hershme luajnë një rol kritik në parandalimin e radikalizmit. Fokusi i këtij raporti është në një qasje të organizuar për të vlerësuar efektivitetin e masave të ndërhyrjes së hershme.

Raporti monitorues shqyrton praninë e policimit në komunitet, krijimin e Këshillave të Sigurisë në Komunitet dhe angazhimin e shkollave dhe komuniteteve lokale në parandalimin e radikalizmit.

Ky raport monitorues lë jashtë matjes dhe trajtimit mekanizmat e tjerë të mbrojtjes, reagimit dhe ndjekjes por ndërsa synon që të ofrojë një pasqyrë të qartë të aktiviteteve në parandalimin e hershëm.

Hulumtimi për të dhënat është zhvilluar në periudhën korrik 2023 - 31 maj 2024, në një kohë kur në Kosovë ka pasur sfida serioze të rendit dhe sigurisë kombëtare nga aktivitetet terroriste.

Gjatë kësaj kohe, në veriun e vendit por edhe në zona të tjera të Kosovës janë shënuar incidente të cilat lidhen me grupet terroriste të ekstremit të djathtë sidomos të dy organizatave terroriste “Mbrojtja Civile” dhe “Brigada e Veriut”. Sulmi në Banjskë në shtator të 2023 dhe disa dhjetëra incidente e sulme ndaj policisë dhe institucioneve i janë atribuar këtyre grupeve ndërsa në disa raste në kufijtë e Kosovës janë shfaqur përkrahës të grupeve të ekstremit të djathtë nga Serbia dhe Mali i Zi.

Në anën tjetër, te komuniteti shqiptar është konstatuar të paktën një incident serioz. Në rajonin e Podujevës, disa përkrahës të Kishës Ortodokse Shqiptare të Elbasanit u arrestuan pasi tentuan ta pushtonin një kishë ortodokse serbe dhe ta shpallnin atë si kishë shqiptare. Incidenti pasoi me arrestimin dhe ngritjen e aktakuzës për disa prej klerikëve ndërsa ende nuk është analizuar në tërësi se cilës ideologji i përkasin aktivistët e kësaj organizate.

Në zhvillimet rreth grupeve ekstremiste pati disa incidente të cilat iu atribuuan motiveve fetare. Grupe të radikalizuara të mbështetura nga ideologjitë radikale islamike u përfshinë në djegien e Gjykatës në Kaçanik ndërsa një grup tjetër u përfshi në grabitjen e armatosur të një argjendarie në Suharekë. BIRN vëren se brenda komunitetit islam pati disa konflikte në mes imamëve të ndryshëm për çështjen e dominimit në disa xhami ndërsa u konstatuan edhe sigurta ku xhami të caktuara si rasti i xhamisë në Viti nuk iu bindën autoriteteve lokale të BIK. BIRN ko

Në aspektin politik, gjatë kësaj kohe vendi pati sfida shumë të mëdha për shkak se Lista Serbe u largua nga qeveria dhe institucionet tjera. Përkrahësit e kësaj partie politike gjatë gjithë kohës bënë thirrje kundër aktiviteve të institucioneve dhe thirrën në bojkot të tyre në zonat ku serbët përbëjnë shumicën e popullatës. Si rrjedhojë, autoritetet e vendit patën sfida shumë të mëdha për të arritur që të realizojnë investime dhe trajtim të qytetarëve në këto zona.

Deklaratat dhe veprimet e Listës Serbe për të minimizuar besimin në institucione ishin përditshmëri gjatë gjithë vitit.

Në rrafshin politik, te partitë politike shqiptare pati diskutime dhe kundërshtime të forta për Ligin për Fekondimin Artificial dhe për Kodin Civil i cili parasheh regjistrimin e martesave të gjinisë së njëjtë.

Lëvizjet kundër komunitetit LGBTI+ në kuadër të partive politike shqiptare vlerësohen të jenë të motivuara nga elemente të ekstremit të djathtë.

III. Metodologjia

Kjo raport monitorues vlerëson dhe pasqyron procesin në Kosovë drejt zhvillimit dhe funksionalizimit të një sistemi të reagimit dhe ndërhyrjes së hershme për të mbrojtur dhe mbështetur individët që janë të cenuar nga radikalizimi.

Qëllimi i këtij raporti monitorues është "mbledhja dhe prezantimi i te dhënave mbi implementimin e masave të planifikuara në Strategjinë Shtetërore për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizmit 2023-2028, specifikisht shtyllën e tretë të objektivit të Parandalimit "Ndërhyrjen e hershme për të mbrojtur dhe mbështetur individët e cenueshëm nga radikalizimi."

Një aspekt i rëndësishëm i qasjes së monitorimit është vlerësimi i ndikimit të nismave qeveritare dhe joqeveritare në të katër fushat. Ky vlerësim shqyrton se si këto veprime kontribuojnë në qëllimin gjithëpërfshirës për ruajtjen e vlerave dhe interesave të Republikës së Kosovës dhe mbrojtjen e qytetarëve të saj nga kërcënimet e paraqitura nga ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi.

Për mbledhjen e të dhënave për hartimin e këtij raporti janë përdorur disa metoda, të cilat i shërbejnë mirë qëllimit të trekëndëzimit të gjetjeve. Metodatat kryesore përfshijnë: Burimet kryesore të të dhënave do të përfshijnë raportet e qeverisë, statistikatat zyrtare dhe të dhëna të tjera zyrtare nga qeveria, sondazhet, intervistat me aktorët kryesorë dhe studime të tjera ose raporte joqeveritare.

Metodat kryesore përfshijnë:

Rishikimi i dokumenteve: BIRN ka kryer një rishikim gjithëpërfshirës të mbi 30 dokumenteve duke përfshirë literaturën akademike, dokumente të politikave, raporteve dhe studimeve të rasteve në lidhje me masat e ndërhyrjes së hershme për parandalimin e radikalizimit. Kështu janë identifikuar temat, teoritë dhe kornizat kryesore të rëndësishme për strategjitë e ndërhyrjes së hershme, duke përfshirë faktorët që kontribuojnë në radikalizimin, qasjet e ndërhyrjes dhe metodat e vlerësimit.

Anketa: Një pyetësor është përgatitur dhe shpërndarë tek aktorët kryesorë të zbatimit të Strategjisë në nivel qendror dhe lokal.

Intervistat e thella me aktorët kryesorë: janë realizuar 10 Intervista me aktorët kryesor të ngarkuar për zbatimin e aktiviteteve të Planit të Veprimit të Strategjisë, duke filluar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Kryetarin e Komunës së Hanit të Elezit, dhe koordinatoret e dy mekanizmave multidisiplinar. Intervistat janë realizuar bazuar në një pyetësor të hartuar paraprakisht i përbërë nga pyetje rreth treguesve kryesorë. Është përdorur një teknikë gjysmë e strukturuar e intervistës cilësore do të përdoret për të siguruar që të mbulohet gjithë tematika e analizës, duke lejuar njëkohësisht të intervistuarit të prezantojnë në mënyrë të pavarur tema të rëndësishme të ndërlidhura me çështjen e trajtuar.

Vëzhgime të drejtpërdrejta: Vëzhgimi i drejtpërdrejtë i aktiviteteve është zbatuar për të kuptuar sa më mirë metodologjinë e zbatimit të Strategjisë. Është vëzhguar punëtorja e organizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës, (me datën 4,5 dhe 6 dhjetor 2023) në të cilën është raportuar rreth zbatimit të aktiviteteve që burojnë nga Strategjia për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizmit 2023-2028 dhe Plani i Veprimit 2023-2025

Të dhënat e grumbulluara nga aktorët e ndryshëm për qëllim të këtij raporti janë kërkuar për periudhën kohore 1 korrik 2023 - më 31 maj 2024 që përkon me miratimin e Strategjisë nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 29 qershor 2023.

Për realizimin e këtij raporti, BIRN ka dërguar pyetësor në të gjitha komunat e Kosovës nga të cilat 26 kanë kthyer përgjigje, ndër to edhe 7 komuna e mëdha të vendit dhe 3 komuna të banuara me shumicë serbe. Po ashtu, në nivel lokal janë intervistuar edhe Koordinator i Mekanizmit multidisiplinar në Komunën e Hanit të Elezit, z. Amir Bushi, dhe Koordinator i Mekanizmit Multidisiplinar në Mitrovicë të Jugut, z. Bahtir Maxhuni.

Po ashtu për qëllim të këtij raporti është intervistuar edhe Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, z. Mehmet Ballazhi.

Në nivel qendror, BIRN ka realizuar intervistë më znj. Aferdita Jaha nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe z. Mensur Hoti, Drejtor i Departamentit për Siguri Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Komuna që nuk kanë kthyer përgjigje:

1	Suharekë
2	Lipjan
3	Partesh
4	Graçanicë
5	Mamushë
6	Novobërdë
7	Malishevë
8	Zveçan
9	Zubin Potok
10	Vushtrri

IV. Gjetjet kryesore: Analiza e progresit në nivelin e prodhimit

Identifikimi i grupeve të popullsisë të synuara për t'u radikalizuar dhe faktorët nxitës dhe tërheqës drejt radikalizimit, është një nga veprimet primare që duhet të ndërmerren me qëllim të përmbushjes së shtyllës së tretë të objektit strategjik “Parandalimi”, të Strategjisë për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizmit 2023-2028 dhe Planit të Veprimit 2023-2025 (më tej referuar si Strategjia).

Me qëllimin specifik që të programohet dhe realizohet ndërhyrja sa më e hershme për t'i mbrojtur dhe mbështetur ata që janë më të rrezikuar nga radikalizmi, Strategjia aktuale ka paraparë kryerjen e një studimi empirik që do të evidentonte grupe më të cenueshme të popullsisë ndaj radikalizmit dhe faktorët nxitës dhe tërheqës.

Ky segment i analizës pasqyron situatën aktuale në nivel qendror dhe në veçanti nivelin lokal se a e kanë kryer apo planifikojnë të kryejnë një studim të tillë, cilat ishin gjetjet rreth grupeve të cenueshme dhe faktorëve nxitës dhe tërheqës, kush e ka hartuar dhe cili ishte procesi i hartimit dhe si po përdoren gjetjet e këtij studimi për qëllim të Strategjisë dhe ku po bazohen ndërhyrjet specifike që derivojnë nga Strategjia në rast se nuk kemi identifikim të grupeve të cenueshme të popullsisë.

Ky Raport monitorues pasqyron se niveli lokal, pra komunat, ndër aktorët vendimtarë të Strategjisë, nuk kanë arritur të hartojnë ndonjë dokument që identifikon grupet e cenueshme të popullsisë ndaj radikalizimit, nuk arrijnë të trajtojnë faktorët nxitës dhe tërheqës dhe nuk përditësojnë vazhdimisht çasjen e tyre. Në anën tjetër, niveli qendror, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike vepron kryesisht në bazë të mësimave të nxjerra nga rastet e mëparshme. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në anën tjetër bazohet në një dokument – doracak të hartuar para rreth 4 viteve i cili nuk është përditësuar dhe i cili i dedikohet më shumë identifikimit të shenjave të para të radikalizmit sesa identifikimit të grupeve të cenueshme të popullsisë.

“MPB nuk ka një listë apo studim specifik që identifikon grupet ma të cenueshme mirëpo ka një listë të grupeve që vlerësojmë se janë në rrezik. Fokusi ynë kryesor në këto raste është të shkollat, arsimit, MASHT në përgjithësi dhe për këtë specifikë Ministria e Arsimit e ka një manual i cili është i shpërndarë te të gjithë mësimmshënësit dhe te drejtorët e shkollave. Ky manual është i para rreth 4 viteve”, ka thënë Mensur Hoti për BIRN.¹

Sipas Hotit, aktualisht për MPB-në parandalimi është prioritet, si një fushë që nuk ka pasur një mbulueshmëri shumë të madhe në të kaluarën për arsye se kryesisht janë përqendruar te R&R dhe nuk kanë pasur shumë aktivitete mbi parandalimin, teksa tani, kjo çështje përbën fokusin kryesor.

Grup tjetër në fokusin tonë janë edhe të rinjtë ku hyn edhe çështja e radikalizmit online që është më sfiduese. Prej të dhënave empirike dhe hulumtimeve si fokus i kemi grupet dhe rajonet që kanë qenë më të prekura nga ku qytetarët tanë janë përfshirë në Siri dhe Irak. Hoti deklaroi se Doracaku nuk është përditësuar dhe nuk e sheh urgjente nevojën e përditësimit sepse bëhet fjalë për shenjat e identifikimit të hershëm dhe për aktivitetet dhe hapat që duhet të ndërmerren kur mësuesit e identifikojnë dikë.²

1. Intervista e realizuar nga BIRN me z.Mensur Hoti – Drejtor i Departamentit për Siguri Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës.

2. Intervista e realizuar nga BIRN me z.Mensur Hoti – Drejtor i Departamentit për Siguri Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës.

BIRN gjen që në komunën e Mitrovicës ku është krijuar mekanizmi referues, grupi nuk e ka pranuar dokumentin strategjik ndërsa në një komunë tjetër - atë të Hanit të Elezit - strategjia është pranuar. Mungesa e dokumentit bazik ka krijuar probleme të tjera sistematike. Komunitat nuk kanë hartuar planet e veçanta të implementimit të strategjisë dhe nuk kanë caktuar personat përgjegjës për t'u marrë me aktivitetet konkrete në terren. Në nivelin qendror, strategjia është dërguar te ministritë e linjës përgjegjëse për implementimin e aktiviteteve.

TABELA 1.

Komunitat që kanë një studim empirik	Komunitat që nuk kanë një studim empirik dhe nuk ofrojnë të dhëna se ku bazohen	Komunitat që nuk kanë studim por bazohen te Policia dhe Strategjia	Gjithsej komunitat që kanë kthyer përgjigje
2	21	3	26
Peja dhe Obiliq			
Gjetjet	<p>Komunitat e Pejës deklaron si gjetje të studimit se nuk ka popullatë të identifikuar si të cenueshme për radikalizëm dhe faktorë të tjerë që i kontribuojnë radikalizmit.</p> <p>Komunitat e Obiliqit deklaron se në bazë të studimit të tyre rezulton se të rinjtë janë kategoria më e cenueshme nga radikalizmi.</p>		

Të dhënat tregojnë se 22 nga 26 komunitat që i janë përgjigjur pyetësorit të BIRN nuk kanë kryer ndonjë studim empirik apo hulumtim për të identifikuar grupet e popullsisë të cenueshme për radikalizëm si dhe faktorët shtytës dhe tërheqës.

Vetëm 2 komunitat, Peja dhe Obiliq janë përgjigjur se kanë kryer studime të tilla teksa asnjëra nga komunitat nuk ka ofruar më shumë detaje specifike rreth studimit përveç se kanë përshkruar gjetjet e tyre.

Pasur parasysh vizionin strategjik të Strategjisë 2023-2028 që synon një fuqizim të rolit të nivelit lokal përmes themelimit të mekanizmave multidisiplinar në kuadër të komunave kjo gjetje është mjaft shqetësuese sidomos kur kemi parasysh se vetëm 3 nga komunitat që kanë kthyer përgjigje i referohen Strategjisë, Planit të Veprimit të Strategjisë apo bashkëpunimit me Policinë si orientim për ndërtimin e ndërhyrjeve të tyre që rrjedhin nga Strategjia.

TABELA 2.

Indikator 1	Komuna	A është kryer ndonjë studim empirik ³	Nëse po, cilat janë gjetjet e këtij hulumtimi, cilat janë grupet e cenushme dhe cilat janë gjetjet mbi aktorët që shpijnë në radikalizim dhe terrorizëm?	Nëse përgjigja në pikën 1 është 'po' si përdoren këto gjetje për qëllim të Strategjisë për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizmit?	Nëse përgjigja në pikën 1 është 'jo', në çfarë baze ndërtohen intervenimet specifike që derivojnë nga Strategjia për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizmit?
1	Prishtinë	Jo	n/a	n/a	n/d
2	Prizren	Jo	n/a	n/a	n/d
3	Pejë	Jo	Nuk ka popullatë të identifikuar për radikalizim si dhe faktorë të tjerë që i kontribuojnë procesit të radikalizimit.	Nuk ka gjetje	n/a
4	Gjakovë	Jo	Përveç ndonjë diskutimi të rrallë në mbledhjet e KKSB-së, Komuna deri më tani nuk është marrë me këtë temë sepse është trajtuar nga niveli qendror.	n/d	n/d
5	Gjilan	Jo	n/d	n/d	n/d
6	Ferizaj	Jo	n/d	n/d	Në bashkëpunim me organet gjegjëse
7	Kaçanik	Jo	n/a	n/a	n/d
8	Viti	Jo	n/a	n/a	n/d
9	Hani i Elezit	Jo	n/a	n/a	n/d
10	Shtime	Jo	n/a	n/a	Në Komunën e Shtimes nuk ka pasur asnjë shfaqje të asnjë forme të ekstremizmit ose terrorizmit. KKSB për çdo rast analizon nëse ka shenja që çojnë në terrorizëm
11	Istog	Jo	n/a	n/a	n/d
12	Skenderaj	Jo	n/a	n/a	n/d
13	Rahovec	Jo	n/a	n/a	n/d


3. Pyetja e plotë - A është kryer ndonjë studim empirik mbi grupet e popullsisë të targetuara për radikalizim dhe ndonjë hulumtim për identifikimin e shfaqjeve dhe formave të ndryshme që çojnë në ekstremizëm të dhunshëm dhe radikalizim ?

14	Drenas	Jo	n/a	n/a	n/d
15	Klinë	Jo	n/a	n/a	n/d
16	Kamenicë	Jo	n/a	n/a	n/d
17	Klllokot	Jo	n/a	n/a	n/d
18	Ranillug	Jo	n/a	n/a	n/d
19	Junik	Jo	n/a	n/a	Përmes Strategjisë, aktiviteteve specifike
20	Obiliq	Po	Grupe të cenueshme janë të rinjët dhe të rejat	Përdoren në parandalim	n/a
21	Dragash	Jo	n/a	n/a	n/d
22	Deçan	Jo	n/a	n/a	n/d
23	Mitrovicë e Jugut	Jo	n/d	n/d	n/d
24	Podujevë	Jo	n/d	n/d	n/d
25	Fushë Kosova	Jo	Jo	Jo	Jo
26	Leposaviq	Jo	Jo	Jo	Jo

Tema - Lista e grupeve të popullsisë të synuara për radikalizëm dhe të ndjeshme ndaj faktorëve nxitës dhe tërheqës ndaj radikalizimit

Plani i Veprimit 2023-2025 i Strategjisë ka paraparë disa aktivitete të cilat kushtëzohen nga një parakusht, një listë gjithëpërfshirëse dhe që përditësohet në vazhdimësi dhe ku evidentohen grupet e synuara për radikalizim dhe të ndjeshme ndaj faktorëve nxitës dhe tërheqës. “Ngritja e kapaciteteve të psikologëve për ndërhyrjen e hershme për të mbrojtur dhe mbështetur ata që janë më të rrezikuar nga radikalizmi”, “Vizitat e punëtorëve social te familjet e cënueshme dhe të prekura”, “Ligjërata për grupet e cënueshme për kundër narrativave”, janë disa nga aktivitetet që si target ka grupet e cënueshme apo personat më të rrezikuar nga radikalizmi.

Nga të dhënat e mbledhura për realizimin e këtij raporti – pyetësorët - pasqyrohet se niveli lokal nuk ka ndonjë dokument apo listë të tillë gjithëpërfshirëse dhe që përditësohet në mënyrë të vazhdueshme ku evidentohen këto grupe apo persona, rrjedhimisht praktika që ndiqet nga komunat është vetëm ‘post festum’,- pra tek pas paraqitjes së rastit, evidentohen dhe listohen mirëpo në kontekst të parandalimit dhe identifikimit të hershem nuk ka një listë apo kritere.



Nga intervistat e realizuara nga BIRN me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Arsimit rezulton se këto ministri po ashtu nuk kanë një liste specifike gjithëpërfshirëse të subjekteve të synuara për t'u radikalizuar. Rastet trajtohen vetëm në bazë të të dhënave empirike të mbledhura gjatë trajtimit të rasteve deri më tani.

Sipas të dhënave të sigurura nga BIRN, përmes intervistës me MPB-në, lista e subjekteve ma të cënueshme lidhet fillimisht me rrethin ku subjektet jetojnë apo rrethin e tyre familjar. Rastet që po na paraqiten edhe tani, kryesisht bazën e kanë në edukimin familjar, pra kryesisht subjektet që po na referohen janë më radikal në shpjegimin dhe kuptimin fetar⁴.

4.Intervista e realizuar nga BIRN me z.Mensur Hoti – Drejtor i Departamentit për Siguri Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës.

TABELA 3.

Indikator 2	Komuna	A ka një listë apo dokument të grupeve të popullsisë të synuara për radikalizëm dhe të ndjeshme ndaj faktorëve nxitës dhe tërheqës ndaj radikalizimit përpilohen dhe a përditësohen periodikisht.	Nëse po, si është hartuar kjo listë dhe në çfarë procesi ka kaluar hartimi i listës?	Sa gjithëpërfshirëse dhe të përditësuara rregullisht janë këto lista?	Si përdoren këto lista për hartimin e programeve intervenuese?
1	Prishtinë	Jo	n/a	n/a	n/a
2	Prizren	Jo	n/a	n/a	n/a
3	Pejë	Jo	n/a	n/a	n/d
4	Gjakovë	Jo	n/d	n/d	Kjo çështje nuk ka qenë në kompetencat e komunës.
5	Gjilan	Jo	n/a	n/a	n/d
6	Ferizaj	Jo	n/a	n/a	n/d
7	Kaçanik	Jo	n/a	n/a	n/d
8	Viti	Jo	n/a	n/a	n/d
9	Hani i Elezit	Po	Lista është hartuar pas paraqitjes së rasteve dhe ofrimit të shërbimeve	Ne kemi punuar në baza ditore dhe kur ka pasur nevojë kemi përditësuar	Pas paraqitjes së rastit menjëherë fillohet me vlerësim dhe më pas me intervenim.
10	Shtime	Jo	n/a	n/a	n/a
11	Istog	Jo	n/a	n/a	n/a
12	Skenderaj	Jo	n/a	n/a	n/a
13	Rahovec	Jo	n/a	n/a	n/a

14	Drenas	Jo	n/a	n/a	n/a
15	Klinë	Jo	n/a	n/a	n/a
16	Kamenicë	Jo	n/a	n/a	n/a
17	Klllokot	Jo	n/a	n/a	n/a
18	Ranillug	Jo	n/a	n/a	n/a
19	Junik	Jo	n/a	n/a	n/a
20	Obiliq	Po	n/a	n/a	n/a
21	Dragash	Jo	n/a	n/a	n/a
22	Deçan	Jo	n/a	n/a	n/a
23	Mitrovicë e Jugut	n/d	n/a	n/a	n/a
24	Podujevë	n/d	n/a	n/a	n/a
25	Fushë Kosova	Jo	Jo	Jo	Jo
26	Leposaviq	Jo	Jo	Jo	Jo

Tema - Hartimi dhe shpërndarja e një udhëzuesi për institucionet për identifikimin e faktorëve të rrezikut të hershëm të radikalizimit

Përgatitja e hulumtimeve për identifikimin e shfaqjeve të formave të ndryshme dhe faktorëve të ndryshëm që çojnë në ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizëm që shpie në terrorizëm është aktiviteti i parë i shtyllës së parë të objektivit të parë strategjik – Parandalimit, të Planit të Veprimit 2023-2025 të Strategjisë 2023-2028.

Realizimi i hulumtimit, realizimi i takimeve të rregullta të rregullta mujore për identifikimin e shkaktarëve shtytës dhe tërheqës, identifikimi i shkaktarëve, listimi i shkaktarëve dhe mbi të gjitha shpërndarja e këtij dokumenti tek institucionet përbën një nga obligimet më të rëndësishme që derivojnë nga Strategjia dhe Plani i Veprimit të Strategjisë.

Ky dokument doracak nuk është hartuar ende teksa Ministria e Punëve të Brendshme është në fazën fillestare të planifikimit të këtij dokumenti që parashihet të realizohet në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave, universitetet, shoqërinë civile.

Ky doracak sipas MPB-së, është i buxhetuar të realizohet deri në fund të këtij viti teksa nuk është e sigurt se do të mund të kryhet këtë vit. Vlerësohet si përparësi që MPB, Departamenti për Siguri Publike e ka edhe Divizionin që merret me hulumtime, analiza dhe statistika dhe që është i ngarkuar me këtë obligim.⁵

Deri më tani nuk kemi ndonjë input nga MASHTI, Akademia e Shkencave apo kushdo tjetër përveç Institutit të Psikologjisë së Universitetit të Prishtinës. Ata kanë hartuar një raport dhe MPB është duke punuar me ta për dizajnim të hapave të ardhshëm që do t'i kemi në këtë drejtim.⁶

Ky raport i titulluar **“Nga Siria në Shtëpi”**, trajton faktorët nxitës dhe tërheqës mirëpo i trajton vetëm nga këndi i një fokus grupi të caktuar pasi që trajton vetëm subjektet që ishin pjesë e luftërave jashtë vendit.

Deri në nxjerrjen e këtij dokumenti, aktivitetet zhvillohen në nivelin lokal në Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) dhe në veçanti në Këshillat Lokale për Siguri në Bashkësi (KLSB) si mekanizma të Policisë dhe udhëhiqen prej Policisë në Komunitet.

Këta mekanizma kanë aktivitete me qytetarët ku mbajnë takime dhe kontakte mirëpo këto aktivitete zhvillohen më shumë në spektrin e gjerë të parandalimit dhe shenjave të hershme të identifikimit. Deri më tani prej shenjave të hershme të identifikimit, të cilat derivojnë nga dokumente shkencore identifikohen shenjat më të shpeshta si ndryshimi i sjelljes, shoqërimi, vizitimi dhe të tjera.

Në veçanti, nga MPB vlerësohet projekti i Këshillit të BE-së “Nico” nga i cili ka përfituar Policia në Komunitet që është trajnuar.

5. Intervista e realizuar nga BIRN me z.Mensur Hoti – Drejtor i Departamentit për Siguri Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës.

6. Intervista e realizuar nga BIRN me z.Mensur Hoti – Drejtor i Departamentit për Siguri Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës.

Nga MPB vlerësohet edhe roli primar i MASHTI deri më tani në drejtim të identifikimit të shenjave të hershme të radikalizimit. Në këtë drejtim ka ndihmuar edhe **Doracaku i MASHTI për mësimdhënës “Parandalimi i Ekstremizmit të Dhunshëm”**, dokument i vitit 2018 që është ende në zbatim dhe ka për qëllim “që të ofrojë udhëzime për mësimdhënësit në Kosovë për trajtimin e sfidave konkrete të paraqitura nga ekstremizmi i dhunshëm në mjedisin shkollor”.

Sipas MPB-së, falë edhe këtij Doracaku dhe bashkëpunimit me MASHTI, vetëm gjatë vitit janë identifikuar dhe referuar 4 raste të cilat janë duke u trajtuar nga Divizioni për Parandalim dhe Ri-integrim të Personave të Radikalizuar.

Viti	2026
Raste të referuara që po trajtohen nga Divizioni për Parandalim dhe Ri integrim të Personave të Radikalizuar ⁶	4 Raste

Megjithatë, ky është një doracak i destinuar për nevoja të mësimdhënësve për qëllim të identifikimit të shenjave të hershme të nxënësit, pra ka një spektër shumë të fokusuar dhe mbi të gjitha është i vitit 2018 dhe nuk është përditësuar.

TABELA 4.

Indikatori 3	Komuna	A është hartuar dhe shpërndarë ndonjë udhëzues për institucionet për identifikimin e faktorëve të rrezikut të hershëm të radikalizimit?	Nëse përgjigja është ‘po’, kush e ka hartuar në cilat institucione është shpërndarë dhe si është shpërndarë ky udhëzues?	Sa efektivisht përdoret nga palët përkatëse të interesuara?	Nëse përgjigja është “jo”, si udhëzohen institucionet për identifikimin e faktorëve të hershëm të rrezikut të radikalizimit?
1	Prishtinë	Jo	n/a	n/a	n/a
2	Prizren	Jo	n/a	n/a	n/a
3	Pejë	Anëtarët e KKS-së mbajtën trajnim me temën: Fuqizimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi	QKSS “Strategjia për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpirtë në terrorizëm dhe roli i nivelit lokal në zbatimin e tij,	n/d	QKSS
4	Gjakovë	Jo	n/d	n/d	n/d
5	Gjilan	Po	Mekanizmi Referues ka realizuar trajnime të ndryshme dhe në mesin e tyre edhe me ekspertët nga Britania e Madhe (NICO) dhe në si MR e përdorim “Kornizën e vlerësimit të cënueshmërisë”	Në këtë dokument identifikohen 22 faktorë identifikues	n/d

6	Ferizaj	Jo	n/d	n/d	Në bazë të dyshimeve apo denoncimit të ndonjë rasti specifik nga qytetarët
7	Kaçanik	Jo	n/d	n/d	n/d
8	Viti	Jo	n/d	n/d	n/d
9	Hani i Elezit	Jo	n/d	n/d	n/d
10	Shtime	Jo	n/d	n/d	Në bazë të strategjisë dhe planeve të veprimit
11	Istog	Jo	n/d	n/d	n/d
12	Skenderaj	Jo	n/d	n/d	n/d
13	Rahovec	Jo	n/d	n/d	n/d
14	Drenas	Jo	n/d	n/d	n/d
15	Klinë	Jo	n/d	n/d	Në bazë të raportimit të udhëheqësve të institucioneve relevante
16	Kamenicë	Jo	n/d	n/d	n/d
17	Klllokot	Jo	n/a	n/a	Nuk kemi identifikime të hershme
18	Ranillug	Jo	n/d	n/d	n/d
19	Junik	Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit	Geveria e Kosovës	n/d	n/d
20	Obiliq	Jo	n/a	n/a	Vetëdije dhe parandalim
21	Dragash	Jo	n/a	n/d	n/d

22	Deçan	Jo	n/a	n/d	n/d
23	Mitrovicë e Jugut	Jo	n/a	n/d	n/d
24	Podujevë	Jo	n/a	n/d	n/d
25	Fushë Kosova	Jo	Jo	Jo	Jo
26	Leposaviq	Jo	Jo	Jo	Jo

Në këtë situatë, niveli lokal ka gjetur modalitete të ndryshme dhe rezultojnë se përdorin referenca të ndryshme sa i përket çështjes së identifikimit të shenjave të hershme të radikalizimit. Të dhënat e këtij raporti evidentojnë se vetëm Komuna e Gjilanit është përgjigjur pozitivisht duke thënë se kanë një udhëzues që u shërben për identifikimin e shenjave të hershme të radikalizimit, teksa evidentojnë se kanë ndjekur trajnime në kuadër të projektit “NICO” ndërsa si Mekanizëm Referues, komuna e Gjilanit e përdor dokumentin **“Korniza e vlerësimit të cënueshmërisë”**.

Përveç Komunës së Gjilanit, Komuna e Pejës evidenton se nuk kanë një udhëzues mirëpo kanë ndjekur trajnime në temën “Fuqizimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi”, të organizuar nga QKSS, mirëpo i referohen Strategjisë së kaluar “Strategjisë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që shpie në terrorizëm”. Komuna e Ferizajt deklaron se institucionet lokale udhëzohen në bazë “dyshimeve apo denoncimeve të qytetarëve”, ndërsa Komuna e Shtimes që po ashtu deklarojnë se nuk kanë ndonjë udhëzues mirëpo veprojnë në “bazë të strategjisë dhe planeve të veprimit”.

Këto të dhëna evidentojnë se komunat kanë një proces të pa unifikuar të trajtimit të rasteve, si dhe se nuk kanë ndonjë udhëzues të përgatitur për nevoja lokale e aq më pak një udhëzues që do të identifikonte edhe shenjat e para të shfaqura të radikalizimit kundrejt specifikave individuale që mund t'i kenë komunat e Kosovës.

Komunat që deklarojnë se kanë një udhëzues për identifikim të shenjave të hershme të radikalizimit

1 Komuna e Gjilanit

Komunat që e kanë një udhëzues për identifikim të shenjave të hershme të radikalizimit

25

Tema - Policimi në komunitet shtrihet në lokalitete me njerëz të cenueshëm ndaj radikalizimit dhe zbatohet rregullisht

Policimi në komunitet vlerësohet si njëri prej mekanizmave parandalues të policisë ndaj të gjitha dukurive negative e në veçanti në çështjet që kanë të bëjnë me ekstremizëm të dhunshëm dhe terrorizmin - identifikimin e hershëm të shenjave të kësaj dukurie, për shkak të besimit të ndërsjellë që ky koncept synon të ndërtojë në mes të mekanizmave të sigurisë dhe komunitetit.

Policimi në Komunitet është një formë organizimi dhe bashkëpunimi, një strategji organizative veprimi që fokusohet në krijimin e lidhjeve me komunitetin dhe kështu i mundëson policisë të punojë nga afër me anëtarët e komunitetit për të gjitha çështjet që rrezikojnë dhe cenojnë sigurinë publike.

Qëllimi i këtij koncepti është edhe që qytetarët të marrin përgjegjësinë që u takon për sigurinë publike duke i bashkërenduar dhe ndihmuar veprimeve të policisë e po ashtu t'i mundësojë komunitetit t'i arrijnë t'i transmetojnë nevojat e tyre për siguri nga afër tek policia dhe kështu ndërtohet mirëbesim i ndërsjellë.

Republika e Kosovës çështjen e Policimit në Komunitet e ka të rregulluar përmes dy dokumenteve strategjike, **Strategjia e Policimit në Bashkësi 2017-2021⁷** dhe **Strategjia dhe Plani i Veprimit "Policimi në Bashkësi" 2012-2016**.

Në kontekst të parandalimit dhe luftimit të terrorizmit, Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2023-2025, Policimi në Komunitet zë një vend shumë të rëndësishëm në veçanti sa i përket çështje së parandalimit -identifikimit të hershëm.

Sipas MPB-së, zhvillimet që duhet të ndodhin më tej në kontekst të policimit në komunitet janë avancimi me staf, vazhdimi i trajnimeve specifike, shtimin e stafit.

Synimi i MPB-së është që përveç shtimit të fuqizimit të zbatimit të këtij koncepti, policimi në komunitet të shndërrohet në adresën e parë për t'u njoftuar rreth problemeve që mundet t'i ketë komuniteti.⁸

Të dhënat e siguruar nga 26 komuna të Kosovës pasqyrojnë se konceptimi i policimit në komunitet ka shtrirje në 9 komuna, teksa në 15 komuna të tjera nuk ka shtrirje.

Asnjëra nga 26 komunat nuk ka ofruar ndonjë rezultat specifik duke përfshirë edhe komunat në të cilat ky koncept gjen shtrirje, teksa vlerësohet se vetë prania dhe komunikimi i vazhdueshëm në komunitet i policisë, i kontribuon parandalimit.

Nga 9 komunat të cilat janë përgjigjur se ka shtrirje konceptimi i policimit në komunitet, rezulton si sfidë numri i vogël i zyrtarëve policor në raport me nevojat e komunitetit, mungesat logjistike.

7. Strategjia për Policinë në Bashkësi 2017-2012 dhe Plani i veprimit, e qasshme në likun -

<https://www.kosovopolice.com/ep-content/uploads/2020/07/1.-Strategjia-dhe-Plani-i-Veprimit-2017-2021-Policimi-ne%CC%88-Bashke%CC%88si-.pdf>

8. Intervista e realizuar nga BIRN me z.Mensur Hoti – Drejtor i Departamentit për Siguri Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës.

Rast me interes përbën Komuna e Klinës. Nga përgjigjet e kësaj Komune për BIRN rezultojnë se kanë shtrirë konceptin e policimit në komunitet në dy lokalitete me njerëz të cënueshëm, në bashkësinë lokale në Sferkë dhe në Jashanicë. Komuna e Klinës nuk ka ofruar ndonjë sqarim se në bazë të çfarë rrethanash i kanë cilësuar këto dy lokalitete apo grupe të njerëzve në këto lokalitete si "të cënueshëm ndaj radikalizmit", e po ashtu në pyetësorin e plotësuar nga kjo Komunë, nuk ka të dhëna se kanë një studim empirik, listë apo doracak në bazë të së cilit identifikohen këta persona apo grupe si të cënueshëm ndaj radikalizmit.

Policimi në Komunitet	Ka shtrirje dhe funksionon	Nuk ka shtrirje apo nuk ka të dhëna
	9 komuna	17 komuna

TABELA 5.

Indikator 4	Komuna	Deri në çfarë mase është shtrirë koncepti i policimit në komunitet në lokalitetet me njerëz të cënueshëm ndaj radikalizmit?	Cilat janë rezultatet dhe sfidat kryesore që lidhen me zbatimin e rregullt të këtij koncepti?	Cili është niveli i zbatimit të konceptit të policimit në komunitet?	Si kontribuon koncepti i policimit në komunitet në parandalimin e radikalizmit? A ka ndonjë rezultat specifik?
1	Prishtinë	Po	Janë të formuara KLSP-të nga Policia sipas ligjit dhe janë në bashkëpunim të plotë me Policinë dhe Komunitat përmes KKSb.	n/d	n/d
2	Prizren	Jo mjaftueshëm	Nuk ka rezultat konkrete	Mesatar	n/a
3	Pejë	Jo	Nuk ka grupe të radikalizimit	n/d	Jo, nuk ka ndonjë rast specifik
4	Gjakovë	n/d	n/d	n/d	n/d
5	Gjilan	n/d	n/d	n/d	n/d
6	Ferizaj	n/d	n/d	n/d	n/d
7	Kaçanik	Çdo lokalitet ka policinë e lokalitetit	n/d	i mirë	Nuk ka ndonjë hulumtim
8	Viti	n/d	n/d	n/d	n/d
9	Hani i Elezit	Nuk kemi	n/d	n/d	n/d
10	Shtime	Nuk ka specifika pasi që siguria në bashkësi analizohet dhe përcillet njëkohësisht edhe me mekanizma tjera	Rekomandimet nga takimet e ndryshme të KKSb dhe liderëve duke filluar nga kryetari i komunës.	Bashkëpunim i kënaqësëm	Komuna e Shtimes ka bashkëpunim të ngushtë me Policinë e Kosovës.

11	Istog	Nuk ka	n/d	n/d	n/d
12	Skenderaj	Në lokalitete të caktuara	Mungesë logjistike	Pjesërisht	Pjesërisht
13	Rahovec	Koncepti i policimit në komunitet kontribuon në forma të ndryshme duke përfshirë patrullime permanente, kontakte me qytetarë, biznese, forume të sigurisë, këshillave të fshatrave dhe të sigurisë, personave me ndikim në komunitet, prijës fetar.	Rezultatet janë në nivel të duhur për faktin që nuk kemi pasur asnjë rast të raportuar të kësaj natyre ndërsa si sfida janë: numri i vogël apo jo proporcional i zyrtarëve policor në raport me dendësinë e popullatës, niveli i arsimet dhe edukimit të popullatës.	Nivel mesatar me synim nivelin e lartë.	Konceptimi i policimit në komunitet kontribuon në mënyrë të ndryshme duke përfshirë patrullime permanente, kontakte me qytetarë, biznese, forume të sigurisë, këshillave të fshatrave dhe të sigurisë, personave me ndikim në komunitet, prijës fetar.
14	Drenas	Janë mbajtur ligjëрата vetëdijësuese bashkëpunim DKA – Policia	n/d	n/d	n/d
15	Klinë	Koncepti i policimit në komunitet në lokalitete me njerëz të cenusëshëm ndaj radikalizimit është shtrirë në dy bashkësi lokale, në Sferkë dhe Jashanicë, sipas nevojave të vlerësuara në koordinim me institucionet përgjegjëse.	Një koncept i tillë i ka sfidat dhe rezultatet e veta. Sipas këtij koncepti bëhen takime dhe merren të dhëna në teren nga institucioni relevantë dhe zyrtarët përgjegjës të caktuar.	Janë caktuar zyrtarët në të cilat operojnë zyrtarët në bazë të nevojave dhe planifikimeve të institucionit përgjegjës, ku mbledhen të dhëna dhe mbahen takime.	Kjo ka një ndikim të rëndësishëm për uljen e rrezikut të përhapjes së radikalizimit dhe shërben si i masë preventive.
16	Kamenicë	n/d	n/d	n/d	n/d
17	Klllokot	Nuk ka njerëz të cenusëshëm	Nuk ka rezultate	I mirë	n/d
18	Ranillug	Po	Mjaftueshëm	I mirë	n/d
19	Junik	Policia e Kosovës vepron sipas planeve të saj	Nuk kemi pasur ndonjë rast të radikalizimit	n/d	n/d
20	Obiliq	I kënaqshëm	Sfidë është identifikimi i këtyre rasteve	I kënaqshëm	Kontribuon sepse veprohet sipas udhëzimeve të parapara
21	Dragash	n/d	n/d	n/d	n/d
22	Deçan	Shtrirja sipas Policisë së Kosovës	Informim	Mjaftueshëm	Koordinim me Stacionin e Policisë
23	Mitrovicë e Jugut	n/d	n/d	n/d	n/d
24	Podujevë				
25	Fushë Kosova	Jo	Jo	Jo	Jo
26	Leposaviq	Jo	Jo	Jo	Jo

Tema - Themelimi dhe funksionalizimi i Këshillave të Sigurisë në Komunitete me njerëz të cenueshëm ndaj radikalizimit

Këshillat Komunal të Sigurisë në Bashkësi (KKSBB) si mekanizmat të themeluara nga kuvendet komunale dhe të udhëhequra nga kryetari i Komunës dhe Këshillat Lokal të Sigurisë Publike (KLSP) të themeluara nga policia në rajone, janë mekanizma shumë të rëndësishëm komunal në kontekst të Strategjisë, specifikisht parandalimit dhe identifikimit të hershëm.

Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi janë mekanizma komunalë për siguri të cilët janë themeluar për të përmirësuar sigurinë dhe stabilitetin në bashkësi.

Ndër objektivat kryesor të KKSBB-së janë rritja e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal, identifikimi i brengave lidhur me sigurinë publike, rekomandimi i planeve të veprimit dhe adresimi i brengave të qytetarëve te autoritetet komunale; ndërtimi i besimit në mes të policisë dhe qytetarëve nëpërmjet ndërtimit të partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në çdo bashkësi, përfaqësimi i pikëpamjeve dhe shqetësimeve të të gjithë qytetarëve, për çështjet e krimit dhe për çështjet tjera që lidhen me kualitetin e jetës.⁹

Sipas Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 të Ministrisë së Punëve të Brendshme, KKSBB duhet të takohen, së paku 6 herë në vit ndërsa anëtarëve të KKSBB-së u takon kompensimi financiar që duhet të kryhet nga komunat përkatëse.

Përbërja e KKSBB-së fillon që nga kryetari i komunës, komandanti i stacionit të policisë në komunë, përfaqësuesi i secilës bashkësi fetare, përfaqësuesi i secilit komunitet etnik, kryesuesi i komitetit për komunitete, zyrtari për barazi gjinore, drejtori i arsimit, kryetari i këshillit të prindërve, përfaqësuesi i FSK-së, përfaqësuesi i KLSP-së, sektori i emergjencave, përfaqësuesi i ojq-ve, mediave, komunitetit të biznesit dhe përfaqësuesi i personave me aftësi të kufizuara.

Sipas MPB-së, këshillat janë ë prej mekanizmave më të rëndësishëm në nivel komunal sepse themelohen prej kryetarit dhe aty janë të gjitha drejtoritë ekzekutive të komunës të cilat kanë detyra dhe përgjegjësi që derviojnë prej Strategjisë për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizmit 2023-2028 dhe Planit të Veprimit 2023-2025.

Të dhënat e grumbulluara dhe analizuara nga BIRN evidentojnë se nga 26 komuna që janë përgjigjur, vetëm në 10 komuna Këshillat Komunal të Sigurisë në komunitet janë funksional, teksa 14 komuna nuk kanë qenë në gjendje që të ofrojnë përgjigje pozitive rreth funksionalitetit, rolit dhe ndikimit që kanë këto këshilla në parandalimin e radikalizimit.

Roli i këshillave të sigurisë në bashkësi është kyç edhe në realizimin e konceptit të policimit në komunitet teksa kur kemi parasysh vizionin strategjik dhe rolin që synon Strategjia t'ia jap nivelit lokal, sidomos deri në themelimin e mekanizmit multidisiplinar, mungesa e funksionalitetit të këtyre këshillave e lë një hapësirë shumë të madhe në sigurinë publike të komunave përkatëse.

⁹Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 të Ministrisë së Punëve të Brendshme i qasshëm në linkun - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8204>

Për më tepër të dhënat e grumbulluara nga BIRN lidhur me aktivitetet dhe diskutimet e KKSB-ve, pasqyrojnë se nga 213 takime sa janë mbajtur gjatë viteve 2023 dhe 2026, vetëm 7 herë është diskutuar çështja e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.

Numri i takimeve të Këshillave të Sigurisë në Bashkësi ¹⁰	Takimet në të cilat është diskutuar ekstremizmi i dhunshëm si temë gjatë vitit 2023 dhe 2026	
2023	149	7 takime
2026	64	
Gjithsejt	213	

TABELA 6.

Indikator 5	Komuna	Në çfarë mase janë krijuar dhe funksionalizuar Këshillat e Sigurisë në Komunitet në lokalitetet me njerëz të cenueshëm ndaj radikalizimit dhe funksionojnë rregullisht?	Çfarë roli po luajnë Këshillat në parandalimin e radikalizimit?	Sa të suksesshëm janë këto Këshilla në lokalitete me njerëz të cenueshëm ndaj radikalizimit?	Si kontribuon koncepti i policimit në komunitet në parandalimin e radikalizimit? A ka ndonjë rezultat specifik?
1	Prishtinë	Po	KLSP-të janë formuar në të gjitha bashkësitë lokale dhe në zonat e përgjegjësisë të stacioneve policore dhe përmes kryesisht shprehin të gjitha problemet dhe faktorët e ndryshëm kriminal	n/d	n/d
2	Prizren	KKSB janë funksionalizuar sipas kornizës ligjore	Roli rekomandues dhe këshillues	Nuk u jepet hapësirë për të kontribuar në parandalim dhe për të pasur suksese	Jo shumë
3	Pejë	KKSB është organ i krijuar për të adresuar çështjet e sigurisë në nivel lokal dhe si i tillë funksionon rregullisht dhe përbëhet nga përfaqësues të komunës, policisë, shkollave, përfaqësues tjerë të komuniteteve dhe konfeksioneve fetare	KKSB luan rol kyç në identifikimin e problemeve, përmirësimin e sigurisë dhe cilësisë së jetës në komunitet	Ka potencial për të qenë shumë efektiv në parandalimin e radikalizimit	Mbahen së paku 6 mbledhje në vit por numri mund të tejkalohet varësisht prej nevojave.
4	Gjakovë	Gjakova nuk ka këshilla të tillë	n/d	n/d	n/d
5	Gjilan	Këtë aktivitet e realizon Mekanizmi referues	n/d	n/d	n/d
6	Ferizaj	n/d	n/d	n/d	n/d
7	Kaçanik	Jo	n/d	n/d	n/d
8	Viti	Po	n/d	n/d	Për më shumë se një vit e gjysmë puna e KKSB-së ka filluar të zbehet për shkak të mos pagesës së mëditjes së anëtarëve.

10. Të dhënat e siguruar nga BIRN nga Ministria e Punëve të Brendshme.

9	Hani i Elezit	n/d	n/d	n/d	n/d
10	Shtime	Nuk ka grupe të cenushme	n/a	n/a	Sa herë që mbahen takime për çështje të sigurisë.
11	Istog	n/d	n/d	n/d	n/d
12	Skenderaj	Funksional	pozitiv	n/d	Në kushte normale
13	Rahovec	KKSB-të janë krijuar bazuar në kërkesën dhe nevojën në komunitet dhe funksionojnë rregullisht dhe mbajnë takime të rregullta.	Luajnë rol të rëndësishëm në evidentimin, adresimin, dhe parandalimin e të gjithë dukurive që janë të dëmshme për shoqërinë.	n/a	Mbajnë takime të rregullta dhe sipas nevojës c aktojnë rendin e takimeve.
14	Drenas	n/d	n/d	n/d	n/d
15	Klinë	n/a	n/a	n/a	n/a
16	Kamenicë ¹¹	n/d	n/d	n/d	n/d
17	Klllokot	n/d	n/d	n/d	n/d
18	Ranillug	Po	n/a	Shume i suksesshëm	n/a
19	Junik	KKSB-të janë komponent kyçe në zbatimin e strategjisë së policimit në komunitet duke përfshirë edhe lokalitetet me njerëz të cenushtëm ndaj radikalizimit.	Roli i tyre është diskutimi dhe dhënia e rekomandimeve nëse ka ndonjë rast të radikalizimit.	Vlerësojmë se janë të suksesshme pasi që nuk kemi pasur asnjë rast të radikalizimit.	Funksionojnë në bazë të planit të punës por nëse është e nevojshme edhe më shpesh dhe mund të trajtohet çdo temë.
20	Obiliq	Këshillat e Sigurisë funksionojnë shumë mirë dhe organizojnë edhe fushata të ndryshme në parandalim	Kanë rol shumë të rëndësishëm në parandalim.	Kemi realizuar projekte me donator dhe ojq	6 herë në muaj
21	Dragash	n/d	n/d	n/d	n/d
22	Deçan	Po	Koordinohen me Policinë	n/a	n/d
23	Mitrovicë e Jugut	n/d	n/d	n/d	Sipas nevojës
24	Podujevë	Jo	n/d	n/d	n/d

11. Përgjigje e Komunitetit të Kamenicës për BIRN - KKSB i Komunitetit të Kamenicës në planet vjetore të punës dhe të vitit 2023 dhe 2026 nuk kanë paraparë të diskutohen tema për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit pasi që Komuna njihet për tolerancë ndëretnike.

25	Fushë Kosova	Jo	Jo	Jo	Jo
26	Leposaviq	Jo	Jo	Jo	Jo

Tema - Shkollat në lokalitete me njerëz të cenueshëm ndaj radikalizimit punësojnë psikologë dhe profesionistë të tjerë për t'u marrë me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit

Roli i sistemit arsimor dhe i shkollave në veçanti për parandalim – identifikim të hershëm është vendimtar. Strategjia dhe Plani i Veprimit 2023-2025 parashohin që shkollat do të kenë kapacitete profesionale për ndërhyrjen e hershme për të mbrojtur dhe mbështetur ata që janë më të rrezikuar nga radikalizimi. Për këtë qëllim janë paraparë një sërë ndërhyrjesh dhe iniciativash.

Punësimi i psikologëve shkollorë, pedagogëve dhe profesionistëve tjerë dhe trajnimi i tyre për identifikimin e hershëm të shenjave të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit, janë obligime kritike që i vendosë Strategjia me qëllim të realizimit të objektivit strategjik – parandalimit.

Në këtë drejtim, të dhënat evidentojnë se niveli lokal ka bërë përpjekje përmes shtimit të numrit të psikologëve në disa komuna, mirëpo është tejet i madh numri i komunave që nuk kanë qenë të gjendje që të dëshmojnë se kanë kryer ndonjë veprim në këtë drejtim.

9 nga 26 komunat që i janë përgjigjur BIRN deklarojnë se nuk kanë angazhuar psikolog ose nuk kanë ofruar ndonjë dhënë se kanë angazhuar psikologë në shkolla apo ndonjë profesionistë tjetër.

8 nga 26 komunat që i janë përgjigjur BIRN kanë deklaruar se në periudhën kohore që është objekt i këtij raporti kanë angazhuar psikolog. Gjilani 5 psikologë, Kaçaniku 3, Obiliqi 3, Deçani 4, Hani i Elezit 1, Ranillug 1 dhe Skenderaj 3, teksa Komuna e Podujevës deklarojnë se janë të punësuar 9 psikolog mirëpo nuk saktësojnë sa prej tyre janë në periudhën kohore objekt i këtij raporti.

Komunat që kanë angazhuar psikolog ose pedagog gjatë periudhës që është objekt i analizës	Komuna e Gjilanit	Komuna e Kaçanikut	Komuna e Obiliqit	Komuna e Podujevës	Komuna e Deçanit	Komuna e Hani të Elezit	Komuna e Skenderajt	Komuna e Ranillugut
Numri i psikologëve të angazhuar	5 (12 janë gjithsej)	3	3	99 psikologë 3 pedagogë	4	1	3	1
Komunat që planifikojnë të angazhojnë psikolog gjatë vitit 2026-25	Mitrovica e Jugut 6 psikologë Aktualisht e ka vetëm 1							

Përveç angazhimit të psikologëve, një obligim tjetër që vendosë Plani i Veprimit i Strategjisë për nivelin lokal është edhe Informimi i Këshillave të Prindërve për identifikimin e formave të hershme të ekstremizmit të dhunshëm përmes takimeve teksa obligimi për nivelin qendror është i përbashkët për MASHT dhe MPB që të hartojnë programin informues për Këshillin e Prindërve.

Këshilli i Prindërve është një mekanizëm që përfaqëson prindërit dhe i përcjellë mendimet e tyre në ministri për të gjitha çështjet e arsimit para universitar në MASHT (Këshilli i Prindërve të Kosovës), në drejtoritë komunale të arsimit (Këshilli Komunal i Prindërve) dhe në shkolla (Këshilli i Prindërve të Shkollës). Logjika e njëjtë e hierarkisë ndiqet edhe me rastin e raportimit që duhet të bëjë Këshilli i Prindërve teksa funksionimi i këtij mekanizmi rregullohet me akt nënligjor.¹³

Në kontekst të Strategjisë 2023-2028 dhe Planit të Veprimit 2023-2025, roli i prindërve dhe familjes në përgjithësi është vendimtar për identifikimin e shenjave të hershme tek fëmijët teksa janë vendosur dy aktivitete specifike lidhur me këtë mekanizëm.

Të dhënat e BIRN të siguruara nga pyetësorët dëshmojnë se 20 nga 26 komuna që i janë përgjigjur pyetjeve të BIRN, nuk e kanë përmbushur obligimin e tyre që derivon nga Strategjia dhe Plani i Veprimit teksa vetëm 6 prej komunave kanë mbajtur takime informuese me Këshillin e Prindërve për këtë tematikë.

Komuna që kanë informuar Këshillin e Prindërve lidhur me identifikimin e shenjave të hershme të ekstremizmit të dhunshëm	6
Komuna që nuk e kanë informuar Këshillin e Prindërve lidhur me identifikimin e shenjave të hershme të ekstremizmit të dhunshëm	20

12. Udhëzimi Administrativ nr. 01/2023. Zgjedhja Themelimi dhe Funksionimi I Këshillit të Prindërve, i qasshëm në linkun - <https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-me-nr-01-2023-zgjedhja-themelimi-dhe-funksionimi-i-keshillit-te-prinderve-2/>

13. Udhëzimi Administrativ nr. 01/2023. Zgjedhja Themelimi dhe Funksionimi I Këshillit të Prindërve, i qasshëm në linkun - <https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-me-nr-01-2023-zgjedhja-themelimi-dhe-funksionimi-i-keshillit-te-prinderve-2/>

TABELA 7.

Indikator 6	Komuna	Cfarë nismash janë ndërmarre nga shkollat në lokalitet me njerëz të cenusëshëm ndaj radikalizimit që të punësojnë psikologë dhe të tjerë për t'u marrë me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm? Sa efektive janë ato në identifikimin dhe adresimin e rreziqeve të radikalizimit?	Sa psikologë dhe profesionistë të tjerë janë punësuar në shkolla të vendosura në zona me njerëz të cenusëshëm ndaj radikalizimit?	Si i kontribuon prania e tyre në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit?	Si përdoren këto lista për hartimin e programeve intervenuese?	Sa psikologë shkollor janë punësuar në këtë periudhë kohore?
1	Prishtinë ¹⁴	n/d	n/d	n/d	n/d	n/d
2	Prizren	Nuk ka pasur nisma të tilla	Nuk kemi persona të specifikuar	n/d	Nuk ka	Nuk ka informata
3	Pejë	Pejë Janë organizuar fushata të ndryshme ndërgjegjësimi	Nuk ka zona të identifikuara e njerëz të cenusëshëm ndaj radikalizimit	Psikologët në shkolla luajnë rol të rëndësishëm në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit me identifikimin e shenjave të hershme, ofrimin e programeve edukuese për zhvillimin e aftësive sociale dhe rritjen e ndërgjegjësimit.	n/d	n/d
4	Gjakovë	Shumica e shkollave kanë psikologë të rregullt, të cilët krahas temave tjera mund të merren edhe me çështje të radikalizimit. Nuk kemi statistika.	n/d	n/d	n/d	n/d
5	Gjilan	Kërkesat për shtimin e numrit të psikologëve drejtuar Drejtorisë së Arsimit.	5 psikologë shkollor janë punësuar këtë vit 12 janë gjithsej Këta psikologë japin kontribut të madh përmes aktiviteteve ekstrakurrikulare dhe projekteve të ndryshme	DKA ka bërë ristrukturimin e pozitive të psikologëve shkollorë ku i ka ndarë në psikologë për mësindhënie dhe psikolog të caktuar në shkolla	4 janë aktualisht Nuk ka pasur të punësuar tjerë	n/d
6	Ferizaj	Cdo shkollë e cila posedon psikologë dhe mundohet të kontribuojë në vetëdijësimin dhe parandalimin e dukurisë së radikalizimit.	n/d	n/d	n/d	n/d
7	Kaçanik	Cdo shkollë ka psikolog	I kontribuon shumë	Shumë mirë	5	3
8	Viti	n/d	n/d	n/d	n/d	n/d
9	Hani i Elezit	Është punësuar me kontratë të veçantë 1 psikologë për 1 vit	1	Punësimi i profesionistëve ka ndikuar shumë procesit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm	1	0
10	Shtime	Sipas planeve të veprimit	Nuk ka raste të veçanta	Nuk ka raste për asnjë intervenim	0	n/d
11	Istog	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
12	Skenderaj	n/d	n/d	n/d	3	5
13	Rahovec	5 psikologë në shkolla		Kanë rol shumë të rëndësishëm sepse trajtojnë raste individuale profesionalisht	5	Në qps janë të punësuar gjithsej 10 punëtorë social.

14. Në përgjigjet e Komunës së Prishtinës për BIRN, në këtë çështje përgjigja është "DKA", dhe nuk ka të shtuar asgjë tjetër.

14	Drenas	Jo	n/d	n/d	n/d	n/d
15	Klinë	n/d	n/d	n/d	0	0
16	Kamenicë	n/d	n/d	n/d	n/d	n/d
17	Klllokot	n/d	n/d	n/d	n/d	n/d
18	Ranillug	Psikologët mbajnë rregullisht leksione në lidhje me këtë temë	Me sukses, duke mbajtur seanca dhe leksione të ndryshme	n/d	1	0
19	Junik	Është themeluar Këshilli i Sigurisë në Shkollë	n/d	n/d	1	0
20	Obiliq					
21	Dragash	Jo	n/d	n/d	n/d	n/d
22	Deçan	Ka psikologë nëpër shkollë ku mbahen ligjërata në lidhje me rrezikun që sjellë radikalizmi në shoqëri	4	Pozitivisht	0	4
23	Mitrovicë e Jugut	Në planifikimet e tona rekrutuese për vitin shkollor 2026-25 është punësimiti i 6 psikologëve shkollor në institucionet edukativo-arsimore ku numri i nxënësve e është më i madh.	6 pedagog shkollor dhe 1 psikolog shkollor.			
24	Podujevë	Po	9 psikolog 3 pedagog	Trajtojnë rastet në bashkëpunim me organet kompetente	0	30 (përfshi . edhe kategori tjera të profesionistëve)
25	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
26	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo

TABELA 8.

Indikator 6	Komuna	A është informuar Këshilli i Prindërve për identifikimin e shenjave të hershme të ekstremizmit të dhunshëm?	Sa takime i keni mbajtur me Këshillin e Prindërve?
1	Prishtinë	Jo	Jo
2	Prizren	n/d	n/d
3	Pejë	n/d	n/d
4	Gjakovë	n/d	n/d
5	Gjilan	n/d	n/d
6	Ferizaj	n/d	n/d
7	Kaçanik	Jo	0
8	Viti	n/d	n/d
9	Hani i Elezit	n/d	n/d
10	Shtime	Jo	n/d
11	Istog	n/d	n/d
12	Skenderaj	n/d	n/d
13	Rahovec	Po	3 takime

14	Drenas	n/d	n/d
15	Klinë	n/d	n/d
16	Kamenicë	n/d	n/d
17	Klllokot	Jo	0
18	Ranillug	Po	1
19	Junik	Po	3
20	Obiliq	Po	n/a
21	Dragash	Jo	Jo
22	Deçan	Po	3
23	Mitrovicë e Jugut	n/a	n/a
24	Podujevë	Po	2
25	Fushë Kosova	Jo	Jo
26	Leposaviq	Jo	Jo

Tema - Takimet në lagje/fshatra ndërmjet komuniteteve lokale dhe institucioneve të zbatimit të ligjit, për të ndërtuar besimin dhe partneritetin si mekanizma reagimi ndaj radikalizimit

Përfshirja dhe i komunitetit në luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe në veçanti në parandalim – identifikim të hershëm është parakusht për një proces të suksesshëm.

Angazhimi i komuniteteve lokale përmes mbajtjes së takimeve në lagje, fshatra, lokalitete, me autoritetet e zbatimit të ligjit i kontribuon ndërtimit të besimit dhe partneritetit dhe në instancë të fundit i kontribuon parandalimit të ekstremizmit duke i identifikuar, raportuar e zgjidhur problemet që në gjenezën e tyre

Përfshirja e komunitetit është shumë e rëndësishme për të gjitha mekanizmat ekzistues të sigurisë në nivel lokal si KKSB-së, KLPS, EVSB dhe Këshillave të Prindërve, teksa ky rol do të jetë shumë i rëndësishëm edhe me jetësimin e mekanizmave lokal referues që parashihen me Strategjinë dhe Planin e Veprimit.

Zhvillimi i aktiviteteve për njoftimin dhe edukimit të komunitetit për rolin dhe kompetencat e mekanizmit lokal referues, është një nga obligimet që përcaktohet me Strategji dhe Plan të veprimit me qëllim të përmbushjes së qëllimit të identifikimit të hershëm.

Përderisa mekanizmat referues komunal janë funksional vetëm në 3 komuna dhe janë në proces themelimi edhe në 3 komunat tjera, esenciale është që këshillat komunal të sigurisë të përfshijnë dhe angazhojnë komunitetin në identifikimin dhe parandalimin e radikalizimit.

Të dhënat e grumbulluara nga BIRN përmes pyetësorëve për qëllim të këtij raporti evidentojnë se 14 nga 26 komuna nuk kanë mbajtur takime ose nuk kanë ofruar të dhëna se kanë mbajtur takime me komunitetin për këtë çështje. 4 komuna janë përgjigjur se kanë mbajtur takime me komunitetin dhe kanë treguar forumin përmes së cilit janë mbajtur këto takime, teksa 4 komuna tjera janë përgjigjur se ka angazhim të komunitetit, duke dhënë edhe vlerësim se sa është i angazhuar komuniteti, mirëpo nuk kanë ofruar të dhëna konkrete.

Një emërues i përbashkët i të gjitha komunave që janë përgjigjur është se përveç të dhënave lidhur me forumin ku janë mbajtur takimet, shpeshtësinë e takimeve, nuk kanë ofruar ndonjë rezultat specifik të këtyre takimeve apo nivelit të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit në këto takime.

TABELA 9.

Indikator 7	Komuna	Sa të angazhuar janë komunitetet lokale në përpjekjet për të parandaluar radikalizimin përmes takimeve në lagje/fshatra me institucionet e zbatimit të ligjit, për të ndërtuar besimin dhe partneritetin si mekanizma reagimi ndaj radikalizimit?	Sa rregullisht mbahen këto takime, cila është përbërja e takimeve, sa takime janë mbajtur, cili ka qenë niveli i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit?	Cili është rezultati i këtyre takimeve?	Cilët janë faktorët kryesorë që ndikojnë në angazhimin e komunitetit?
1	Prishtinë	Mbahen takimet e KLSP-ve dhe KKSB	Takimet e KKSB-së mbahen sipas planit të veprimit 6 herë brenda vitit	Rezultatet nga këto takime janë ato të cilat vijnë nga KLSP, të cilat Komuna i realizon përmes formave të saj për sigurinë e qytetarëve	Çështjet e sigurisë në komunitet
2	Prizren	Nuk ka angazhim	3 takime të KKSB-së në 2026	Rekomanduese	Mos trajtimi i mirë në angazhim
3	Pejë	Jo	n/d	n/d	n/d
4	Gjakovë	n/d	n/d	n/d	n/d
5	Gjilan	n/d	n/d	n/d	n/d
6	Ferizaj	Në kuadër të takimeve të KKSB diskutohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë e në veçanti për radikalizimin	n/d	n/d	n/d
7	Kaçanik	Aspak	Asnjë	n/d	n/d
8	n/d	n/d	n/d	n/d	n/d
9	Hani i Elezit	Komunitetet lokale bëjnë përpjekje të vazhdueshme për të ndaluar çdo dukuri negative.	Mbajnë takime të shpeshta	I mirë	Mirëqenia e qytetarëve
10	Shtime	Sipas Strategjisë dhe Planit të Veprimit	Nuk ka pasur takime për raste të veçanta. Takimet janë mbajtur sipas planit të veprimit	Bashkëpunimi në sferën e arsimit, shëndetësi, zhvillim ekonomik	Nuk ka pasur
11	Istog	Nuk ka	n/d	n/d	n/d
12	Skenderaj	Kanë takime të vazhdueshme	Sipas ligjit	Informimi	n/d
13	Rahovec	Janë themeluar dy KLSP dhe janë mbajtur 2 mbledhje ku është diskutuar edhe radikalizimi EVSB ka mbajtur 3 takime	Takimet mbahen në baza 3 mujore	Nxjerrin raporte dhe konkluzione mbi gjendjen e përgjithshme në komunë	n/d
14	Drenas	n/d	n/d	n/d	n/d

15	Klinë	Nuk ka pasur takime	n/d	n/d	n/d
16	Kamenicë	Nuk ka pasur takime	n/d	n/d	n/d
17	Klllokot	Nuk ka	n/d	n/d	n/d
18	Ranillug	Ka angazhim	Ka pjesëmarrje dhe mbahen sipas nevojës	n/a	n/a
19	Junik	KKSB e ka në plan të punës	Takimet mbahen çdo 2 muaj	Nëse ka raste trajtohen varësisht nga fusha që e mbulon secili anëtar	Ruajtja e harmonisë fetare
20	Obiliq	Komuniteti shumë i interesuar për të marrë pjesë në takime	6 takime në vit	Në takime njoftohemi për gjendjen nga anëtarët	Organizimi i takimeve në vendet ku ata jetojnë ngjall interesim të madh.
21	Dragash	n/d	n/d	n/d	n/d
22	Deçan	Mjaftueshëm	1 herë në muaj	Pozitiv	Një mjedis i sigurt
23	Mitrovicë e Jugut	n/d	n/d	n/d	Sipas nevojës
24	Podujevë	Jo	n/d	n/d	n/d
25	Fushë Kosova	Jo	Jo	Jo	Jo
26	Leposaviq	Jo	Jo	Jo	Jo

Tema - Takime në lagje në lokalitete të cënueshme për të informuar publikun mbi rolin e familjes në identifikimin e ndryshimeve në sjelljen e familjes që mund të lidhen me radikalizimin

TABELA 10.

Indikator 8	Komuna	Cila është shpeshtësia dhe efektiviteti i takimeve që mbahen në lokalitete të ndjeshme ndaj radikalizimit për të informuar publikun për rolin e familjes në identifikimin e ndryshimeve në sjellje që lidhen me radikalizimin?	Sa takime të tilla janë mbajtur, sa shpesh mbahen?	Cili është rezultati i këtyre takimeve?
1	Prishtinë	n/d	n/d	n/d
2	Prizren	n/d	Së paku 1 takim në vit	Informimi
3	Pejë	n/d	n/d	n/d
4	Gjakovë	n/d	n/d	n/d
5	Gjilan	n/d	n/d	n/d
6	Ferizaj	n/d	n/d	n/d
7	Kaçanik	n/d	n/d	n/d
8	Viti	n/d	n/d	n/d
9	Hani i Elezit	6 takime në vit	Çdo diskutim i kontribuon procesit për parandalim të ekstremizmit mirëpo fatmirësisht Komuna nuk është përballur me asnjë kërcënim serioz	n/d
10	Shtime	Nuk ka nevojë për takime të tilla	n/a	Sipas nevojës

11	Istog	Nuk ka	n/d	n/d
12	Skenderaj	Nuk kemi të dhana	Disa takime në vit	Informim mbi sigurinë publike
13	Rahovec	Çdo 3 muaj	6 takime në vit	n/d
14	Drenas	n/d	n/d	n/d
15	Klinë	n/d	n/d	n/d
16	Kamenicë	n/d	n/d	n/d
17	Klllokot	0	0	0
18	Ranillug	n/d	n/d	n/d
19	Junik	n/d	n/d	n/d
20	Obiliq	1 takim në 2026 deri më tani	n/d	n/d
21	Dragash	n/d	n/d	n/d
22	Deçan	Sipas nevojës	1 herë në muaj	
23	Mitrovicë e Jugut	n/d	n/d	n/d
24	Podujevë	n/d	n/d	n/d
25	Fushë Kosova	Jo	Jo	Jo
26	Leposaviq	Jo	Jo	Jo

Tema - Krijimi i materialeve ndërgjegjësuese publike (fletëpalosje, fletushka, etj.) për identifikimin e ndryshimeve në sjellje të njerëzve që mund të lidhen me radikalizmin

Të dhënat e grumbulluara nga BIRN përmes pyetësorëve evidentojnë se 19 nga 26 komunat që janë përgjigjur nuk kanë kryer ndonjë aktivitet ndërgjegjësues për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, identifikimin e hershëm apo edhe vetë Strategjinë dhe Planin e Veprimit. Komuna e Rahovecit në përgjigjen e tyre për BIRN deklarojnë se nuk kanë pasur fushata të tilla për arsye se “Nuk janë mbajtur aktivitete duke parë situatën e qetë dhe mos paraqitjes së rasteve të tilla në komunën tonë”, teksa si më tej deklarojnë se *“Mund të ketë efekte pozitive, por mund të ketë edhe efekte nxitëse, duke i nxitur dhe acaruar persona të caktuar prejdukues të fesë dhe duke parajgykuar për sjelljet dhe veprimet e tyre dhe si rezultat i parajgykimeve mund të ketë edhe nxitje për këto veprime.”*¹⁵, përkundër se këto aktivitete janë paraparë me Planin e Veprimit të Strategjisë dhe janë obligim i nivelit komunal por edhe i atij qendror që të ndërtojnë fushata vetëdijësuese lidhur me aktivitetet, por në veçanti lidhur me shtyllën e parandalimit – identifikimit të hershëm të shenjave të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit.

Në anën tjetër niveli qendror, nga MASHT përmes intervistës deklarojnë se në bashkëpunim me OSBE-CDF ka realizuar disa aktivitete vetëdijëse përmes televizionit, teksa në bashkëpunim me MPB-në dhe CDF në Komunën e Podujevës janë ofruar sesione informuese për mësimdhënës lidhur me riatdhesimin dhe ri-integrimin e fëmijëve të kthyer nga zonat e luftës për 40 mësimdhënës.¹⁶

Po ashtu, MASHT përmes intervistës në bashkëpunim me fondacionin Jahjaga deklarojnë se janë duke e realizuar projektin “Prospero”, ku parashihet ofrimi i programeve informuese për këshillat e prindërve. Lidhur me këtë projekt, sipas MASHT janë hartuar termet e referencës, janë angazhuar dy ekspertë dhe janë përzgjedhur 4 komuna me nga 10 shkolla me të cilat do të punohet.

Po ashtu, MASHT përmes pyetësorëve njoftojnë se gjatë periudhës korrik 2023 – maj 2026, në bashkëpunim me Global Hardware kanë ofruar programin “Promovimi i Pluralizmit dhe Diversitetit në Arsim”.

Shërbimi Korrektues i Kosovës përmes pyetësorit deklarojnë se përmes Inteligjencës Korrektuese në çdo rast përmes ‘raporteve të ndërgjegjësimit’, kurdo që identifikon dukuri dhe veprimtari, njofton të gjitha institucionet korrektuese.

MPB, Mensur Hoti, Drejtor i Departamentit për Siguri Publike në intervistën e realizuar nga BIRN evidenton aktivitetet e BIRN, takimet në 4 komuna me drejtorë e këshilltar komunal për t’i njoftuar lidhur me Strategjinë e re, Planin e Veprimit dhe aktivitetet që komunat kanë për përgjegjësi t’i kryejnë për qëllim të kësaj Strategjie.

15. Përgjigja e Komunës së Rahovecit në pyetësorin e hartuar nga BIRN, datë 27 qershor 2024

16. Përgjigjet e znj.. Afërdita Jaha – Zyrtare e lartë në MASHT për BIRN, datë 11 korrik 2024

TABELA 11.

Indikator 9	Komuna	Çfarë aktivitesh janë ndërmarrë për ndërgjegjësimin e publikut (fletpalosje, fletushka) për identifikimin e ndryshimeve në sjelljen e njerëzve që mund të lidhen me radikalizimin?	Sa ndikim kanë materialet e ndërgjegjësimit të publikut në identifikimin e ndryshimeve në sjelljen e njerëzve lidhur me radikalizimin në Kosovë?
1	Prishtinë	n/d	n/d
2	Prizren	Nuk ka	Do të mund të kishim ndikim për identifikim të hershëm
3	Pejë	n/d	n/d
4	Gjakovë	n/d	n/d
5	Gjilan	8 takime me KLSP-në, si dhe 3 ligjërata me 55 nxënës pjesëmarrës	n/d
6	Ferizaj	n/d	n/d
7	Kaçanik	n/d	asnjë ¹⁷
8	Viti	n/d	n/d
9	Hani i Elezit	Nuk ka pas veprime ¹⁸	n/d
10	Shtime	Nuk ka pasur aktivitete	n/a
11	Istog	Nuk ka pasur	n/d
12	Skenderaj	n/d	n/d
13	Rahovec	Nuk janë mbajtur aktivitete duke parë situatën e qetë dhe mos paraqitjes së rasteve të tilla në komunën tonë	Mund të ketë efekte pozitive, por mund të ketë edhe efekte nxitëse, duke i nxitur dhe acaruar persona të caktuar prejdukues të fesë dhe duke parajgykuar për sjelljet dhe veprimet e tyre dhe si rezultat i parajgykimeve mund të ketë edhe nxitje për këto veprime.

17. Përgjigjet e Komunës së Kaçanikut për BIRN pretendohet se në çdo takim të KKS-së dhe (një në dy muaj) është diskutuar kjo çështje.

18. Hani i Elezit nuk raporton të dhënat për aktivitetet në tabelë por në pyetësor ka paraqitur të dhëna në pjesën e pyetjeve numerike.

14	Drenas	n/d	n/d
15	Klinë	Nuk ka	Nuk ka
16	Kamenicë	Nuk ka	Nuk ka
17	Klllokot	Nuk ka	Nuk ka
18	Ranillug	Nuk ka	Nuk ka
19	Junik	Një broshurë online	Kanë ndikim pozitiv
20	Obiliq	Fushatë përmes njoftimeve në ekranet njoftues	Kanë shumë efekt në ndërgjegjësim
21	Dragash	n/d	n/d
22	Deçan	Nëpërmjet njësitit të PK-së	jo të mjaftueshëm
23	Mitrovicë e Jugut	n/d	n/d
24	Podujevë	S'ka	S'ka
25	Fushë Kosova	Nuk ka	Nuk ka
26	Leposaviq	Nuk ka	Nuk ka

Tema - Identifikimi dhe trajtimi i subjekteve në burgje të cënueshëm ndaj radikalizmit

Aktualisht në Institucionet Korrektuese të Kosovës janë 17 të burgosur që ndërlidhen me terrorizëm ndërsa në periudhën korrik 2023-maj 2026 janë liruar gjithsej 9 subjekte.

Njësia e Inteligjencës Korrektuese ka 12 zyrtarë të trajnuar teksa në sipas SHKK-së në kuadër të projektit të KE-së është përgatitur 'udhëzuesi për ndërgjegjësimin dhe shenjat e radikalizimit', ku janë trajnuar 100 zyrtarë korrektues teksta për ToT janë trajnuar 14 zyrtarë. Nga viti 2022 janë rishikuar 5 programe për të burgosurit dhe janë shtuar 2 të reja.¹⁹

SHKK deklaronë përmes njësive të tyre, NJIK (Njësia e Inteligjencës Korrektuese dhe NJME (Njësia për Menaxhimin e Ekstremizmit) kanë kryer një hulumtim brenda institucioneve korrektuese 'lidhur me identifikimin e disa të burgosurve për vepra të ndryshme penale si të dyshuar për përqafim dhe shpërfaqje të ideologjisë që shpije në radikalizim bazuar në shfaqjen e disa indikatorëve dhe bindjeve ideologjike të cilat shpijnë në ekstremizëm të dhunshëm brenda institucioneve të SHKK-së"

Sipas SHKK-së mbi bazën e këtyre gjetjeve të këtij hulumtimi, janë identifikuar të burgosur fillimisht dhe pastaj janë realizuar bastisje të cilat kanë rezultuar me identifikim të një numri të madh të përdorimit të metodave dhe mjeteve të cilat janë shfrytëzuar nga të burgosurit për të shkëmbyer dhe përçuar mesazhe që mbështesin ideologjinë ekstremiste.

SHKK po ashtu deklaron se kanë një listë me subjekte apo grupe të cënueshme ndaj radikalizmit dhe kjo listë përditësohet sapo të shfaqen indikacione.

Aktualisht SHKK ende nuk ka një udhëzues për identifikimin e faktorëve të rrezikut për identifikim të hershëm të hershëm të përditësuar, por ky proces është afër finalizimit dhe do të shpërndahet pas miratimit.

Sipas MPB-së, rishikimi i këtij dokumenti nga SHKK do të mundësojë një efektivitet edhe më të lartë të identifikimit të shenjave të hershme dhe do të mundësojë që të kemi një dokument sa më konciz.

19. Pyetësori i plotësuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës për BIRN

V. Analiza e Impaktit

Republika e Kosovës ka arritur një progres të kufizuar në identifikimin e hershëm të grupeve dhe individëve të cenueshëm ndaj radikalizmit dhe në parashikimin dhe ndërmarrjen e masave specifike të ndërhyrjes për të mbështetur këto grupe dhe individë si një nga shtyllat kryesore të objektives strategjike – Parandalimi - të Strategjisë Shtetërore për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizmit.

Ky raporton monitorues evidenton se institucionet e thirrura për të zbatuar aktivitetet që ndërlidhen me këtë objektivë janë në fazën fillestare të zhvillimit dhe ngritjes së kapaciteteve për të përmbushur detyrimet që burojnë nga Strategjia dhe Planit i Veprimit.

Aktorët kryesor për zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë ende nuk kanë një listë të grupeve apo individëve të cenueshëm ndaj radikalizmit dhe faktorëve shtytës dhe tërheqës. Niveli qendror janë në fazën fillestare të realizimit të një udhëzuesi për identifikimin e hershëm të shenjave të radikalizmit ndërsa aktualisht MASHT punon me një udhëzues të vitit 2018 të papërditësuar.

Kë mungesë të theksuar të koordinimit dhe përcjelljes së mesazhit strategjik tek niveli lokal nga niveli qendror lidhur me obligimet e tyre kundrejt Strategjisë e kjo ka rezultuar me mos njohje të rolit, detyrave dhe përgjegjësi të nivelit lokal që derivojnë nga Strategjia e kjo ka rezultuar me mospërmbushje të synimit të mekanizmave lokal të sigurisë siç janë këshillat e sigurisë në bashkësi dhe shtrirje të kufizuar të konceptimit të policimit në komunitet.

Progres është arritur në punësimin e profesionistëve – psikologëve në shkolla nga komunat mirëpo ka ngecje në koordinim dhe informim me këshillat e prindërve lidhur me rolin e tyre në parandalimin e hershëm.

Ka ngecje të theksuar sidomos tek niveli lokal në realizimin e fushatave vetëdijsuese në komunitetet lokale për t'i njoftuar lidhur me rolin dhe rëndësinë e mekanizmit multidisiplinar.

Institucionet e Kosovës nuk kanë ndërmarrë hapa konkretë në parandalimin e hershëm të të gjitha formave të terrorizmit

Ky raport monitorimi pasqyron se si shumica e aktiviteteve të parapara në këtë fushë nuk janë realizuar apo janë në fazën përgatitore të nisjes për t'u realizuar. BIRN gjithashtu gjen se aktivitetet e institucioneve vazhdojnë të jenë të fokusuar në trajtimin e ekstremizmit fetar duke lënë boshllëqe të mëdha në ndërtimin e kapaciteteve për trajtimin e ekstremizmit të djathtë.

Institucionet qendrore e lokale kanë probleme serioze në kuptimin e mesazhit strategjik të strategjisë dhe hartimin e planeve individuale të implementimit

Ky raport monitorues pasqyron se Qeveria e Kosovës nuk e ka dorëzuar zyrtarisht dokumentin bazik dhe planin e veprimit të strategjisë të disa prej institucioneve të cilat janë të thirrura për ta implementuar strategjinë. Problemet më serioze janë identifikuar në nivelin lokal ku nuk është dorëzuar strategjia dhe plani i veprimit. Nga 26 komuna të kontaktuar nga BIRN, 22 komuna kanë konfirmuar se nuk e kanë strategjinë dhe planin e veprimit.

Mungesa e dokumentit bazik ka krijuar probleme të tjera sistematike. Komunat nuk kanë hartuar planet e veçanta të implementimit të strategjisë dhe nuk kanë caktuar personat përgjegjës për t'u marrë me aktivitetet konkrete në terren.

Institucionet nuk kanë arritur që mbi bazën e studimeve të identifikojnë grupet e cenueshme dhe individët të ndjeshëm ndaj faktorëve shtytës dhe nxitës të ekstremizmit

Përgatitja e hulumtimeve për identifikimin e individëve dhe grupeve të cenueshme ndaj radikalizmit dhe faktorët nxitës dhe tërheqës, është parakusht për dizajnimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve adekuate nga institucionet me qëllim të identifikimit të hershëm dhe parandalimit.

Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Arsimit, komunat dhe aktorët tjerë nuk kanë kryer studime empirike që identifikojnë grupet e cenueshme të popullsisë ndaj radikalizmit dhe për faktorët nxitës e tërheqës.

Në mungesë të hulumtimeve, grupet e targetuara për aktivitete janë përcaktuar nga MPB në bazë të të dhënave mbi rastet konkrete që kanë pasur në trajtim, ndërsa komunat rezultojnë se janë të painteresuara pothuajse në tërësi në këtë drejtim.

Po ashtu, ky raport evidenton se institucionet në nivelin qendror dhe në nivelin lokal nuk ka arritur të krijojnë një metodologji dhe mekanizëm i cili gjeneron një listë gjithëpërfshirëse, në të cilën evidentohen subjektet e cenueshme për t'u radikalizuar.

Institucionet qendrore ende nuk kanë filluar punën në hartimin e një udhëzuesi për institucionet për qëllim të identifikimit të shenjave të hershme të radikalizmit.

Ky raport monitorues pasqyron se se Ministria e Punëve të Brendshme dhe Universiteti i Prishtinës, Akademia e Shkencave janë në fazën fillestare të planifikimit të hartimit të një udhëzuesi për identifikim të shenjave të hershme të radikalizmit. Ministria e Arsimit ende punon me një doracak të nxjerrë në vitin 2018 që përdoret ende për nevoja të mësimdhënësve teksa Instituti i Psikologjisë i Universitetit të Prishtinës ka realizuar një hulumtim "Nga Siria në Shtëpi" që trajton një fokus grup të caktuar – të rikthyerit nga Siria dhe jo subjektet tjera apo format tjera të ekstremizmit.

Niveli lokal, komunat, si adresë vazhdojnë ta kenë Policinë apo MPB-në, nuk kanë hulumtime specifike për territorin e tyre dhe në disa raste i referohen dokumenteve të kaluara strategjike dhe nuk tregojnë ndonjë iniciativë në këtë drejtim.

Koncepti i policimit në komunitet nuk është zhvilluar mjaftueshëm për të përmbushur rolin në identifikim të hershëm

Koncepti i Policimit në komunitet apo bashkësi është një nga mekanizmat kryesor në shërbim të identifikimit të hershëm të radikalizmit. Ky raport evidenton se në nivelin lokal nuk janë krijuar kapacitetet të plota në këtë drejtim dhe kjo kushtëzohet nga shtrirja e kufizuar, resurset profesionale dhe kushtëzime tjera.

Nga 26 komuna që i janë përgjigjur BIRN, vetëm në 9 prej tyre evidentohet se ky koncept ka shtrirje dhe kuptim të drejtë, mirëpo edhe në këto komuna nuk arrijnë të listojnë ndonjë rezultat konkret apo ndonjë vizion për zhvillim të mëtejshëm për shtrirjen e këtij koncepti.

Këshillat e Sigurisë në Bashkësi nuk e kanë prioritet realizimin e aktiviteteve në kuadër të konceptit për parandalimit të hershëm

Roli i Këshillit Komunal për Sigurinë në Bashkësi si një forum i sigurisë në nivel komunal është esencial në identifikimin e hershëm dhe parandalimin e radikalizimit por edhe të gjitha dukurive tjera që cenojnë sigurinë e komunitetit.

Nga 26 komuna të vendit që i janë përgjigjur pyetësorit të BIRN, rezulton se vetëm në 10 prej tyre Këshillat Komunal të Sigurisë në komunitet janë funksionale. Të dhënat nga BIRN tregojnë që edhe përkundër shqetësimeve serioze në vend mbi ekstremizmin fetar dhe ekstremizmin e djathtë në nivel të këshillave kjo temë është injoruar. Në nivel vendi, nga 213 takime çështja e ekstremizmit të dhunshëm është diskutuar në vetëm 7 takime.

Ministria e Arsimit ka progres të limituar në përmbushjen e objektivave dhe planit të veprimit

Ky raport evidenton se Ministra e Arsimit ka rritur angazhimin e saj në drejtim të implementimit të aktiviteteve. BIRN gjen se pjesa më e madhe e aktiviteteve janë zhvilluar në kuadër të programit R&R dhe nuk ndërlidhen me fazën e hershme të identifikimit si një nga shtyllat e parandalimit. MASHTI është në fazën e hershme të ndërhyrjes me aktivitete me prindërit ndërsa aktivitetet direkte në terren me kampe, mendim kritik nuk janë realizuar edhe pse janë të parapara në planin e veprimit.

Komunat kanë bërë përpjekje për të shtuar numrin e profesionistëve, psikologëve, pedagogëve dhe trajnimin e tyre ndërsa evidentohen shumë mangësi sa i përket informimit të Këshillave të Prindërve dhe takimeve me ta

Ky raport monitorimi evidenton se komunat kanë bërë përpjekje për shtimin e kapaciteteve profesionale që mundësojnë identifikim të hershëm. Në këtë drejtim 8 nga 26 komunat që i janë përgjigjur pyetësorit të BIRN deklarojnë se kanë angazhuar psikologë e pedagogë gjatë periudhës që ka qenë objekt i raportit monitorues, teksa 9 prej 26 komunave deklarojnë se nuk kanë angazhuar psikologë ose nuk ka ofruar të dhëna që evidentojnë një gjë të tillë.

Shqetësues mbetet fakti se, 18 nga 26 komunat nuk e kanë informuar Këshillin e Prindërve sa i përket identifikimit të shenjave të hershme të radikalizimit si një nga obligimet që dalin prej strategjisë. Po ashtu, pjesa më e madhe e shkollave nuk kanë mbajtur takime informuese me Këshillin e Prindërve.

VI. Probleme ndërsektoriale

Tema - Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve qendrore dhe lokale

BIRN ka konstatuar se qeveria e Kosovës nuk e ka dorëzuar zyrtarisht dokumentin bazik dhe planin e veprimit të strategjisë tek disa prej institucioneve të cilat janë të thirrura për ta implementuar strategjinë. Problemet serioze janë identifikuar në komuna ku strategjia dhe plani i veprimit nuk është dorëzuar.

Nga 26 komuna të kontaktuara nga BIRN 21 komuna kanë konfirmuar se nuk e kanë strategjinë dhe planin e veprimit, ndërsa komunat e tjera kanë thënë se janë njoftuar në forma alternative mbi përmbajtjen e strategjisë.

BIRN gjenë që në komunën e Mitrovicës ku është krijuar mekanizmi referues grupi nuk e ka pranuar dokumentin strategjik ndërsa në komunë tjetër atë të Hanit të Elezit strategjia është pranuar. Mungesa e dokumentit bazik ka krijuar probleme të tjera sistematike. Komunat nuk kanë hartuar planet e veçanta të implementimit të strategjisë dhe nuk kanë caktuar personat përgjegjës për tu marrë me aktivitetet konkrete në terren. Në nivelin qendror strategjia është dërguar tek ministritë e linjës përgjegjëse për implementimin e aktiviteteve.

Në anën tjetër, institucionet qendrore, Ministria e Arsimit, Shërbimi Korrektues dhe Shërbimi Sprovues i Kosovës deklarojnë se janë njoftuar për Strategjinë dhe njëkohësisht, e kanë pranuar formalisht, kanë hartuar planet e veprimit dhe kanë caktuar zyrtarët përgjegjës.

MASHT po ashtu deklaron se shkollat publike dhe private dhe drejtoritë komunale të arsimit janë njoftuar për miratimin e Strategjisë dhe po ashtu janë njoftuar për përgjegjësitë që ka MASHT dhe komunat për zbatimin e aktiviteteve²⁰

Nga MPB janë të vetëdijshëm se ka një hendek në komunikim në veçanti me nivelin lokal mirëpo thotë se themelimi i një qendre shtetërore anti-terrorizëm do t'i evitonte këto mangësi. Po ashtu, nga MPB evidentohen aktivitet që BIRN Kosova i ka mbajtur me komunat, ku janë mbajtur takime njoftuese lidhur me Strategjinë dhe aktivitetet e nivelit lokal në Viti, Kaçanik, Gjilan dhe Fushë Kosovë. Në këto takime pjesëmarrës ishin drejtor komunal, këshilltar komunal dhe zyrtar tjerë të komunave dhe në secilin prej këtyre takimeve pjesëmarrës ishin edhe zyrtarë të lartë nga Departamenti për Siguri Publike për t'ju përgjigjur pyetjeve lidhur me Strategjinë dhe Planin e Veprimit.²¹

20. Intervista e BIRN me znj. Afërdita Jaha – Zyrtare e lartë në MASHT.

21. Intervista e BIRN me z. Mensur Hoti, Drejtor i Departamentit për Siguri Publike në MPB

TABELA 13.

Indikator 8	Komuna	A jeni njoftuar komunat me Strategjinë për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizmit 2023 - 2028 nga Ministria e Punëve të Brendshme?	A u është dërguar formalisht komunave kjo Strategji?	A e keni caktuar personin përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë?	A e ka hartuar ende Komuna planin e saj individual për zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë?	A ka një mekanizëm formal për komunikim dhe bashkëpunim në mes të nivelit qendror dhe lokal?
1	Prishtinë	Po	Jo	Jo	Jo	Jo
2	Prizren	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
3	Pejë	n/d	n/d	n/d	n/d	n/d
4	Gjakovë	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
5	Gjilan	Po	Jo	Koordinatori i Mekanizmit referues	Jo	Po, Divizioni MPB
6	Ferizaj	Jo	Jo	Po	Jo	Po
7	Kaçanik	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
8	Viti	n/d	n/d	n/d	n/d	n/d
9	Hani i Elezit	Po	Jemi njoftuar në takime	Zyrtari koordinues i Mekanizmit referues	Jo	Jo
10	Shtime	Po	Po	Po	Jo	Jo
11	Istog	n/d	n/d	n/d	n/d	n/d
12	Skenderaj	Jo	Jo	Jo	Jo	Përmes Policisë
13	Rahovec	Jo	Jo	Jo	Jo	Në kordinimin me Policinë

14	Drenas	Jam njoftuar përmes ueb-faqes ku është publikuar	n/d	Jo	Jo	Përmes KKSB-së me MPB, përkatësisht Divizioni për Siguri në Bashkësi
15	Klinë	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
16	Kamenicë	n/d	n/d	n/d	n/d	n/d
17	Klllokot	Jo	Nuk kemi informata	Jo	Jo	Jo
18	Ranillug	Jo	Jo	Jo	Jo	Përmes Policisë
19	Junik	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
20	Obiliq					
21	Dragash	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
22	Deçan	Jemi informuar nga ueb-faqja	Jo	Jo	Jo	Jo
23	Mitrovicë e Jugut	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
24	Podujevë	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
25	Fushë Kosovë	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
26	Leposaviq	Po	Po	Jo	Jo	Jo

Komuna e Gjakovës duke u përgjigjur në pyetjet thekson se “Përgjigjet janë negative për faktin se zyrtarisht nga qeveria lokale nuk ka pasur asnjë aktivitet zyrtar rreth kësaj teme. Kjo ka ndodhur për dy arsye, e para sepse me këtë çështje është marrë nivel qendror dhe e dyta për faktin se Komuna e Gjakovës është një prej komunave ku radikalizmi dhe ekstremizmi nuk janë pothuajse aspak prezent dhe të gjitha komunitetet fetare bashkëjetojnë në harmoni të plotë”²².

22. Përgjigja e Komunesë së Gjakovës në pyetësorin e hartuar nga BIRN, datë 26 qershor 2024

VII. Përfundime dhe rekomandime

- Koordinatorin Nacional të përmbushë në kohë sa më të shpejtë obligimin për dërgimin e mesazhit strategjik te niveli lokal;
- MPB së bashku me OJQ-të dhe aktorët tjerë të vazhdojnë takimet shpjeguese me strukturat komunale për t'i informuar lidhur me rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre konform Strategjisë për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizmit;
- MPB dhe komunat t'i kushtojnë vëmendje specifike funksionimit të mekanizmave referues të formuar rishtazi si në Hanin e Elezit, Viti dhe Prishtinë, të formalizojnë themelimin e këtyre mekanizmave dhe t'i adresojnë përgjegjësitë e aktorëve komunalë në këto mekanizma;
- MPB, MASHTI dhe Akademia e Shkencave të përshpejtojnë dhe finalizojnë një dokument udhëzues i cili identifikon faktorët nxitës dhe tërheqës, i liston dhe i përditëson këta faktorë dhe identifikon grupet dhe individët e cenueshëm ndaj këtyre faktorëve dhe i përfshin të gjitha format e ekstremizmit;
- Komunitet dhe MPB t'i kushtojnë vëmendje të posaçme policimit në bashkësi si një mjet që ndërton besimin e ndërsjellë në komunitet dhe përmirëson edhe efikasitetin dhe efektivitetin në identifikimin e hershëm;
- MPB, MASHTI dhe Akademia e Shkencave të hartojnë dokument udhëzues lidhur me identifikimin e shenjave të hershme të radikalizimit për të gjitha format e ekstremizmit dhe me fokus të veçantë edhe ekstremizmin e djathtë;
- MASHTI në përputhje me Strategjinë dhe Planin e Veprimit t'i kushtojë vëmendje përmes aktiviteteve edhe identifikimit të hershëm të rrethanave, t'i përditësojë dokumentet udhëzuese dhe t'i shpeshtojë fushatat vetëdijësuese;
- Komunitet të tregohen më pro-aktive dhe të kërkojnë informacione lidhur me Strategjinë dhe Planin e Veprimit nga MPB, të caktojnë zyrtarët përgjegjës dhe të hartojnë planet individuale të zbatimit të aktiviteteve të Strategjisë;
- Komunitet përmes forumeve të sigurisë KKSBB dhe KLSP, ta trajtojnë me prioritet çështjen e ekstremizmit të dhunshëm, në veçanti parandalimit – identifikimit të hershëm;
- Komunitet të vazhdojnë të shtojnë numrin e psikologëve, pedagogëve dhe punëtorëve social dhe t'i fuqizojnë kapacitetet e tyre njohëse për format e ekstremizmit të dhunshëm dhe identifikimin e shenjave të hershme të radikalizimit;
- Komunitet të bëjnë hulumtime për nevojat e tyre konform specifikave individuale të komunave për faktorët nxitës dhe tërheqës, grupet e cenueshme ndaj radikalizimit dhe identifikimin e hershëm;



BIRN
BALKAN
INVESTIGATIVE
REPORTING
NETWORK

KOSOVO

📍 Mensa e Studentëve, Kati I-rë
10000 Prishtina, Kosovo

☎️ +383 38 224 498

🌐 kosovo.birn.eu.com